




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Jashari” pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel.0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Adresa:rr.”Adem

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e dytë (II) të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 11.3.2015 me këtë :

REND PUNE

- 1 Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
- 2 Betimi i anëtarëve të rinj të Kuvendit
- 3 **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 3.1 Raporti i punës për vitin 2014 i kryetarit të Komunës
 - 3.2 Raporti financiar Janar-Dhjetor 2014
 - 3.3 Propozim vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2013 dhe 2014, në vitin fiskal 2015
 - 3.4 Propozim vendimi për lejimin e transferit dhe harmonizimit të mjeteve financiare
 - 3.5 Propozim vendimi për miratimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit dhe Komiteteve të KK-ës për vitin 2015
 - 3.6 Propozim vendimi për anulimin e pjesërishtëm të vendimit 01.nr.7840 të datës 14.07.2009 dhe vendimit 01.nr.16-7086 të datës 30.05.2011
 - 3.7 Propozim vendimi për lejimin e ndërtimit të Palestrës së Sporteve në Zhegër-Komuna e Gjilanit
 - 3.8 Propozim vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për ndërrimin e destinimit të hapësirës së një pjese të PDU :Dardania-I (te ish lokacioni i tregut)
 - 3.9 Rishqyrtimi i nenit 3 pika 1 të Rregullores për plotësim dhe ndryshim të Rregullores për taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale (sipas rekomandimit të Komisionit të përbashkët të MF-MAPL)
 - 3.10 Rishqyrtimi i vendimit 01.Nr.016-9262 për dhënien në shfrytëzim të ngastrës kadastrale P-70403013-00162-8 (sipas rekomandimit të MAPL)
- 4 Të ndryshme

Seanca i filloi punimet në ora 10.10 min.

Në punimet e Seancës së dytë morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri

Zv/kryetari i Komunës, z. Rexhep Kadriu

Drejtorët e drejtorive

Instituti Demokratik i Kosovës, z. Driton Selmanaj

Përfaqësuesi i OSB-së, z. Basri Sejdiu

Përfaqësuesi i Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, z. Fazli Abdullahu

Përfaqësuesi i OJQ "Anamorava", z. Isa Shefkiu

Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, z. Shaban Terziu

Përfaqësuesi i Zyrës Ligjore, z. Hevzi Matoshi

Mediet

Seancën e dytë të KK-së e hapi dhe udhëhoqi, kryesuesja e Kuvendit, zonja Valentinë Bunjaku-Rexhepi e cila e përshëndeti kryetarin e Komunës, zv/kryetarin e Komunës anëtarët e Kuvendit dhe të gjithë të pranishmit e tjerë të cilët janë prezent në punimet e seancës së dytë të Kuvendit.

Në vijim të punimeve, kryesuesja kërkoi që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në punimet e kësaj seance.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
Nga ana e sekretarisë u konstatua se në punimet e kësaj seance ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit (35).

Valentinë Bunjaku Rexhepi- para se të fillojmë me punë fillimisht po iu njoftoj lidhur me konferencë për shtyp të cilën e kam thirr me datë 4.3.2015 në ora 14. Këtë konferencë e kam thirr , sepse ka qenë deshtë të arsyetohen dy vendimet të cilat i kemi marrë si Kuvend, por MAPL-së na i ka kthyer në rishqyrtim, mirëpo gazetarët janë vonuar, sepse kanë qenë në Konferencë me dhurues.

Rendin e punës e kemi marrë, prandaj ju lus që nëse ka dikush ndonjë vërejtje për rendin e punës mund ta merr fjalën.

Fehmi Sylejmani- mendoj se për këtë seancë rendi i punës është shumë voluminoz, sepse për këtë seancë janë paraparë më shumë se 10 pika të rendit të punës. Për këtë arsyeje unë në emër të grupit të LVV propozoj që të shqyrtohen dy pikat e para të rendit të punës; Raporti i kryetarit të Komunës dhe pika 3.2, raporti financiar për vitin 2014 dhe këto të jenë të vetmet pika të cilat do të debatohen në Kuvend. Mirëpo këtyre dy pikave mund t' i shtojmë edhe pikën 3.5 e cila ka të bëjë me orarin e mbledhjeve të Kuvendit.

Propozoj që këto pika të rendit të punës të debatohen në këtë Kuvend, sepse pika 3.1 dhe 3.2 kërkojnë një debat dhe analizë të gjerë.

Bujar Nevzadi- unë po e filloj me kryetarin e Komunës, sepse e kemi problem për ta parë kryetarin e Komunës në seancat e Kuvendit Mandej e kam një reagim, sepse fjala i epet grupit më të madh, prandaj këtë duhet ta dijë zonja kryesuese dhe këtë duhet ta respektoni.

Unë edhe në seancën e KPF-së kam kërkuar që këto pika të rendit të punës të ndahen në dy pjesë, sepse ky rend i punës është shumë i gjerë.

Së treti kërkoj që të më epet fjala dhe të na epet mundësia që të flasim, sepse kryetarin e Komunës nuk ka pasur mundësi ta takoj edhe pas 15 muaj qeverisje. Unë nuk kam dëshirë të dal në medie dhe jap deklarata, por dëshira ime është që të ballafaqohemi në seancë dhe po kam besim se ndoshta do të më mundësohet që të flas 5 minuta më shumë, sepse unë kur kam qenë kryesuese ia kam mundësuar që të flasin anëtarët e Kuvendit edhe pa kufizim kohe në raste të veçanta.

Së pari të gjithë e dinë se dje ka ndodhur një rast me një anëtarë të Kuvendit, sepse bodigardi i Zyrës së Kryetarit e ka sulmuar z. Riad Rashitin anëtarin e Kuvendit nga radhët e PDK-së. Ju jeni pushtet dhe nuk ka nevojë askush ta sulmojë opozitën dhe askush nuk ka të drejtë të sillt në atë mënyrë me anëtarët e Kuvendit.

Përkitazi me atë që e thotë kryesuesja se ka thirr konferencë për shtyp, është mirë që të jetë e sinqertë, sepse ju zonja kryesuese i keni thirr gazetarët për të dhënë dorëheqje, sepse nuk iu ka dhënë një tender familjarëve të juaj dhe jo për arsyen që e thatë. Gjilani dhe Kosova është e vogël dhe nuk ka informatë e cila nuk dihet!

Valentinë Bunjaku Rexhepi- ta kenë të qartë të gjithë anëtarët e Kuvendit se edhe pse në rend pune është Raporti i kryetarit të Komunës do të shkelet Rregullorja e KK-së. Do ta respektojmë çdo pikë dhe presje të kësaj rregullore të cilën edhe vetë Bujari e ka votuar.

Lutfi Haziri- të nderuar anëtarë të Kuvendit dhe të tjerë të pranishëm para se të hyjë në rend të punës, po e bëj publikisht dhe po shpreh keqardhje për rastin e djeshëm, sepse askush nuk ka të drejtë të shkaktojë incidente dhe ky rast është për keqardhje andaj anëtarit të KK-së, z. Riad Rashiti. Nuk ka të bëj këtu me bodigardë, sepse ju e dini që ai është punëtor i sigurimit me kontratë në vepër për shkak të ndërprerjes së kontratës Kompanisë së Sigurimit "Sas". Ai është punëtor i objektit të Ekzekutivit dhe në objektin e kryetarit të Komunës. Duhet të dihet se ai është punëtor i sigurimit dhe jo bodigard, sepse të gjithë e dinë që Lutfi Haziri nuk ka pasur përcjellës dhe bodigardë dhe as nuk do të ketë. Kjo është tendencioze dhe nuk ka nevojë incidentit t' i shtojmë asgjë tjetër! Rasti do të hetohet dhe përveç policisë si organ i shtetit edhe drejtoria përkatëse edhe Zyra ime do ta hetojë rastin deri në fund dhe nuk do të lejojë që të cenohet dinjiteti i askujt e aq më pak i anëtarëve të Kuvendit.

Bajram Hasani- sa i përket rendit të punës edhe unë pajtohem plotësisht me kolegët e mëparshëm që për këtë seancë të debatohen pika 3.1, 3.2 dhe 3.5 ashtu si propozoi anëtari i grupit kuvendar të LVV, në mënyrë që të kemi kohë në mënyrë më detale t' i shqyrtojmë pikët e rendit të punës.

Sa i përket rastit të anëtarit të PDK-së, z. Riad Rashiti është një rast skandaloz, mirëpo e përgëzoj kryetarin për një kërkim falje në një farë mënyre. Unë nuk e kam të qartë se ai person zyrtar i cili i sulmon anëtarët e Kuvendit a është nga kompanitë e sigurimit, apo zyrtar komunal, por ai duhet të suspendohet menjëherë deri në zbardhjen e rastit. Nuk guxon të sulmohet asnjë anëtar i Kuvendit i cili është zgjedhur me votën e popullit.

Isa Agushi- unë i kam disa shqetësime të banorëve të fshatit Zhegër, sepse ambulanca në këtë fshat punon vetëm karter-pesë orë dhe aspak më shumë. Zhegra me fshatrat për rreth i ka 5 mijë banorë dhe për këtë arsyeje duhet të ndërmerret diçka që ambulanca të punojë 24 orë.

Nën dy hajnat kanë filluar me të madhe të veprojnë sipas "zanatit" të tyre dhe arsyet i dini? Është çështja ekonomike, por hajnat duhet dënuar, sepse ata edhe të maskuar po sulmojnë shtëpi dhe njerëz dhe prona biznesore. Për këtë arsyeje Policia e Kosovës të jetë më aktive gjatë 24 orëve.

Pyetje tjetër është për kryesuesen? Bexhat janë premtuar që një kohë të gjatë, por ende nuk i kemi marrë dhe nuk e di pse? Ndërsa vërejtja tjetër është se nuk është mirë uji të shpërndahet gjatë punimeve të seancës, por të shpërndahet më herët.

Avdyl Aliu- unë vetëm propozoj që të vazhdojmë me rendin e punës ashtu edhe si jemi marrë vesh në KPF.

T' i trajtojmë të gjitha këto pikë që i kemi propozuar, po fillojmë mjaft herët, por unë kërkoj nga të gjithë kolegët që të jenë racional në diskutime, ta respektojmë Rregulloren e punës së KK, prandaj mendoj se kemi mjaft kohë për të debatuar për të gjitha pikët e rendit të punës.

Mirëpo edhe në këtë seancë nuk do të mungojë ajo pika e urimeve dhe përshëndetjeve, sepse sot i kemi dy urime. Urimi i parë ka të bëjë me Jakup Bajramin për betimin që do ta jep tash si asamblist i cili tash do të jetë edhe zv/kryesues, sepse është asamblisti më i moshëm, kurse kolegun Zijadinin e falënderojmë për punën të cilën e ka bërë deri më tash. Urimi tjetër ka të bëjë me kolegën tonë Jehonë Hyseni së cilës ia urojmë titullin e magjistares së shkencave juridike.

Fatkeqësisht në këtë Kuvend ka vend edhe për atë që quhet "Kronika e zezë". Unë nuk kam çka të them tjetër, sepse tjerët po e thanë, por kërkoj që të kemi sjellje të dinjitetshme kudo që të gjendemi. Gjithashtu edhe respektim të ligjit dhe respektim të rregulloreve.

Sadullah Kadriu- ka propozime që të reduktohet rendi i punës, dikush bën urime, kurse unë e kam një shqetësim tjetër. Këtu qenka kryetari, zv/kryetari dhe Kuvendi është i kompletuar, prandaj unë po e paraqes një shqetësim lidhur me një marrëveshje që e kemi pasur me drejtorin e Administratës Publike, z. Gagica.

Kërkoj që të jetë në rend të ditës, problemi i nënshtetësisë së qytetarëve të Kosovës Lindore, sepse kjo çështje është diskutuar shumë herë, prandaj kërkoj sot të futet në rend të ditës, sepse unë e kam përgatitur një

material dhe do të shqetësoheni të gjithë përkitazi me atë që do ta them tash. Unë e di që KK nuk ka kompetenca të tilla, por të lëvizim ne pak dhe t' i rekomandojmë Qeverisë dhe MPB që të ndërmerr diçka.

Fehmi Sylejmani- unë për herë të dytë po e marrë fjalën, por kërkoj falje për këtë, sepse në çdo seancë kam kërkuar edhe më herët që në rend dite të jetë pika; pyetje dhe përgjigje. Këtë propozim e ka pranuar edhe kryetari në një formë publikisht me një arsyetim apo modifikim. Kërkoj që kjo pikë të jetë e përhershme në seancë, para rendit të ditës në mënyrë që ne të kemi të drejtë t' i bëjmë pyetje drejtorëve dhe të marrim përgjigje nga ata. Unë shfrytëzoj rastin t' i bëj disa pyetje:

Gjatë fjalës së z. Sylejmani, ndërhyri kryesuesja dhe kërkoj që këtë pyetje të shtrohen në pikën; të ndryshme.

Bujar Nevzadi- unë kësaj radhe po flas në emër të grupit dhe po theksoj se Rregulloren duhet respektuar gjithmonë, por ju nuk e keni respektuar, kurse sot paskeni vendos për ta respektuar. Mirëpo unë kërkoj që të na epet mundësia që të debatojmë, sepse për 15 muaj nuk kemi pasur mundësi për ta takuar kryetarin.

E dyta për shefin e grupit të LDK-së i cili po bë urime, ky person ka bërë cirkus vazhdimisht dhe po vazhdon të bëj, por sa i përket kronikës së zezë është mirë që kjo të rregullohet brenda pushtetit. Ju e dini se drejtori i Inspeksionit është rrahur me zyrtarë në lokale të Komunës. Ju këto gjëra së pari i rregulloni brenda institucionit , pastaj dilni jashtë.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- ky drejtor është rrah edhe në mandatin e juaj edhe më keq se tash!

Avdyl Aliu- unë desha të më kuptoni mirë, sepse e thash se kërkoj sjellje të dinjitetshme të kolegëve. Mirëpo ai drejtori që është rrah ka ardhur i mësuar, sepse ishte mësuar më herët të rrahet.

Riad Rashiti- kërkoj edhe njëherë që ta mësosh Rregulloren e KK-së, sepse ka kaluar një vit dhe duhet ta dish se secili anëtarë i KK-së e ka të drejtën të parashtrojë pyetje.

Unë do t' i bëjë pyetje ushtruesit të detyrës së drejtorit të Drejtorisë së Financave, por njëkohësisht kjo pyetje vlen edhe për kryetarin e Komunës. Unë që nga fillimi ka bërë shumë kërkesa dhe informacione për dokumente në qasje publike. Të gjitha kërkesat janë të bazuar në ligj dhe rregullore dhe të gjitha janë kërkesat janë të drejtuara me kohë, por përgjigje nuk marrë asnjëherë.

Dua ta jap një sqarim për rastin e djeshëm për të cilin rast kryetari i Komunës e dha vlerësimin e vetë, por është mirë që këto raste të mos përsëriten, sepse këto raste që nga mandati i kësaj qeverisje janë bërë dukuri dhe përditshmëri. Unë në Drejtori të Financave e kam kompletuar kërkesën e njëjtë të cilën e kam bërë edhe në fund të janarit, por nuk kam marrë përgjigje. Kam drejtuar kërkesë në shkurt për të njëjtën kërkesë nuk kam marrë përgjigje. Pas bisedës telefonike, drejtori më ka thënë se eja në zyrë dhe merri informacionet, por unë kam ardhur, por përsëri nuk më janë ofruar informacionet. Në keni ftuar që përsëri të vij në ora 13, por si duket që dikush ka urdhëruar që unë të kërcënohem në zyrat e financave. Për mua personalisht nuk është shqetësuese sjellja e individit të caktuar, as nuk e ndiej veten të frikësuar për këto sjellje, por e ndiej veten keqe që në Komunën tonë është krijuar një klimë ku kërcënohen edhe zyrtarët komunal. Kam qenë i pranishëm dje që përveç unë që jam kërcënuar është kërcënuar dhe zyrtari Destan Maloku. Këtij zyrtari i merren dokumentet dhe i hedhen në tokë me kërcënim se nuk guxon t' i ofrojë dokumente anëtarit të Kuvendit. Raste të tilla ka pasur në këtë qeverisje, ka pasur rrahje të mësimdhënësve të mandatit të juaj, nxënësit i keni dërguar me dhunë në ekskursion me kompaninë e juaj të preferuar, prokuroria dhe policia kanë dalë në vend të ngjarjes. Ka ndodhur rrahja dhe burgosja e drejtorit të Inspeksionit. Sa i përket rastit të djeshëm, mua më vjen turp për fyerjet që i bënë anëtarë i KK-së një kompanie publike e që është investitor i huaj. Unë po e them vetëm një fjalë të atij investitori i huaj: ' nuk e di a e din një gjë të tillë deputetët e KK se ke e kanë votuar për anëtar të Komisionit'. Sharje dhe fyerje kanë ndodhur vazhdimisht nga një person privat, por tash ai nuk është person privat, por është nën ombrellën e kryetarit të Komunës, sepse e ka shok pune. Është e turpshme që një vizitor i huaj të fyhet dhe të shahet dhe të kërcënohet.

Nuk pati debatues të tjerë sa i përket rendit të punës, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet rendi i punës?

Aprovohet rendi i punës me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, 3 ishin kundër, kurse të tjerat abstenime.

Procesverbali

Aprovohet procesverbali pa vërejtje, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit

2. Betimi i anëtarit të rinj të Kuvendit

Para anëtarë të KK-së betimin e jap anëtarë i ri i Kuvendit Jakup Bajrami sepse e zëvendëson, Imet Rrahmanin i cili është emëruar në pozitën e ministrit të Shëndetësisë.

Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa

3.1 Raporti i punës së kryetarit për vitin 2014

Lutfi Haziri- kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri e elaboroi punën e tij një vjeçare para anëtarëve të cilin raport anëtarët e Kuvendit e kanë pasur me shkrim.

Avdyli Aliu- kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që t' i them disa fjalë lidhur me raportin e kryetarit të Komunës për vitin 2014. Raporti është i punuar mirë si në aspektin teknik dhe në atë përmbajtësor, sepse në raport janë paraqitur punë, aktivitete, rezultate dhe të arritura, por edhe sfida të cilat e kanë përcjell punën e kryetarit dhe ekipin e tij. Shpresoj se do të kemi mirëkuptim nga kryetari për vërejtje dhe sugjerime eventuale nëse dikush ka, sepse këto vërejtje më vonë do të ndikojnë edhe në ngritjen e performancës së kryetarit dhe të ekipit të tij. Raporti në mënyrë të detajizuar paraqet punën e kryetarit, zyrave të kryetari dhe drejtorive si dhe jep informata në frymën e shërbimeve për qytetarët e Komunës. Siç e dini se e kemi trashëguar një Komunë në një gjendje shumë të rëndë si në aspektin organizativ ashtu edhe në atë financiar. Kemi pasur një buxhet jo mirë të menaxhuar dhe me borxhe të trashëguara. Planifikimin për 2014 e kemi gjetur të gatshëm, por ai planifikim ka qenë aspak premtues dhe aspak ekuivalent me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Mirëpo ne përsëri kemi arrit që atë planifikim aq sa kemi mundur ta përshtatim me politika të mira të zhvillimit të mirëqenies dhe mirëbesimit të humbur. Gjatë kësaj rruge na ka hyrë në punë një faktor me rëndësi të madhe e që ai faktor është transparenca.

Kemi gjet shumë zhgënjime dhe në aspektin social dhe aspekte të tjera i cili zhgënjim ishte akumuluar me vite me radhë. Mirëpo unë lirisht po e them se ne ia kemi dalë që t' ia ndalim hovin asaj dukurie negative. Mirëpo na duhet shumë kohë për ta përfunduar punën e filluar, por punën që jemi duke e bërë është "hakikat".

Disa punë që janë kryer gjatë këtij vitit janë të dukshme për syrin e publikut, disa më pak, por ka edhe të tilla të cilat do të shihen në ditët muajt dhe vitet në vazhdim. Punët të cilat janë bërë dhe po bëhen janë udhëhequr nga një planifikim i mirë. Raporti i kryetarit është një raport i cili komunikon me publikun dhe në këtë mënyrë bëhet edhe një ngritje e performancës. Mirëpo në këtë raport me siguri se do të ketë kritika dhe sugjerime, sepse ndonjë punë ka mundur të ishte bërë më mirë se sa është bërë.

Duhet të dihet se gjatë kësaj periudhe të qeverisjes shumë kohë është harxhuar duke i evituar prishjet dhe defektet të cilat i kemi trashëguar nga qeverisja e mëparshme e që fatkeqësisht e kam thënë edhe më herët se regjistri me këto defekte dhe prishje është shumë i trashë. Një gjë tejet pozitive është se ne në të gjitha drejtoritë së bashku i kemi kursyer 2 milion € dhe të qeverisura mirë nga kjo ekipë, por edhe me kohë është bërë pagesa e shumë borxheve nga operatorët ekonomik. Nuk po e them se kjo është më e mira e mundshmja, ka mundësi edhe më mirë, por besojmë në të më të mirën gjatë së ardhmes. Në emër të grupit të anëtarëve të LDK-së e vlerësoj lartë qëllimin e mirë të kryetari dhe kërkoj që ky raport të aprovohet unanimisht.

Sahit Abazi- fillimisht po theksoj se në emër të grupit të PDK-së do të flet Bujar Nevzadi, kurse ne anëtarët tjetër të grupit do ta marrim fjalën radhas për shkak të rëndësisë që ka kjo pikë e rendit të punës.

Bujar Nevzadi- ne e dëgjuam, por edhe e kemi lexuar raportin e kryetarit, por edhe pa e lexuar në këtë raport e kemi në kontakt çdo ditë dhe e prekim në çdo çast. Sikur të ishte vetëm 50% ashtu i thuhet në raport unë do të isha shumë i kënaqur si qytetar i kësaj komune. Gjithashtu edhe ato që i tha shefi i grupit të LDK-së, nuk i besojnë as anëtarët e vetë, kurse të tjerët edhe më hiq.

Raporti i kryetarit të Komunës i përmban vetëm 5 faqe, kurse të tjerat i ka bërë vetëm përshkrim, prandaj unë mendoj se duhet humbur më tepër kohë për ta bërë një raport më detal dhe më të mirë ashtu siç i ka hije një komune të madhe siç është Komuna e Gjiçanit. Kryetari i Komunës sonë, atë ditë që ka ardhur në pozitë të kryetarit ka ardhur i lodhur, sepse nuk është mësuar të punojë, por vetëm të bëjë politikë nacionale dhe partiake të nivelit qendror. Në mandatin e parë e ka pas edhe zv/kryetarin dhe e ka pasur edhe një kryeshef të cilët ia kanë kryer punët, kurse ky është marrë vetëm me politikë. Kryetari gjithnjë del me disa deklarata shërpe e të cilat më as këto nuk i shkojnë, sepse qytetarët po kërkojnë për t' i zgjidh problemet pse ia kanë

dhënë votën. Kryetari i Komunës shumicën e kohës nuk qëndron në vendin e punës, nuk banon në Gjilan, familjarët e tij nuk mësojnë në shkollat e Gjilanit, si të thuhet se kemi kryetar. Unë po filloj me radhë dhe po përmendi disa skandale të kësaj qeverisje e që kanë qenë deshtë të jenë në raportin e kryetarit.

Së pari asnjëherë nuk kam parë raport me shkrim ku thuhet vetëm lëvdatat për pa u cekur të metat dhe dobësitë, sepse ka pasur raste të shumta të tilla, ka pasur ngecje dhe sfida.

Nuk është kompletuar Qeveria Komunale për 15 muaj! Nuk ka zv/ kryesues, nuk ka drejtor të Shëndetësisë, nuk ka pasur të Kulturës për një vit nuk ka drejtor të Financave.

Sa i përket buxhetit, për herë të parë e pranoni se i keni gjet 4 milion 112 mijë obligime nga qeverisja e kaluar dhe jo 9.5 milion, sa keni deklaruar për 15 muaj.

Ka shumë deklarata kundër PPP-së, kurse tash i përmend projektet e Palestrës së Sporteve, transportin publik, Shkollën e Mesme të Bujqësisë, të gjitha me PPP-në.

Me 5-6 rreshta është folur për Kulturën, Arsimin dhe Shëndetësinë ! Pas presionit që i keni bërë QKMF-së, keni arrit ta shkarkoni drejtorin dhe tash paga marrin dy drejtorë dhe 2 zv/drejtorë.

Nuk është bërë deratizimi dhe dezinfektimi dhe shëndetësi në tërësi është në gjendje tejet të rëndë, sepse në QKMF as gjilpëra nuk ka!

Në Arsim zgjedhja e drejtorëve është bërë pa kritere profesionale dhe largimin e disave pa të drejtë vetëm pse nuk kanë pasur librezë partiake të LDK-së. Është bërë pranimi i punëtorëve pa konkurs, por edhe kur keni shpall konkurs nuk i keni respektuar kriteret. Raste të tilla ka në “Th. Mitko”, “Selami Hallaç” Dobërzan dhe shumë shkolla të tjera, por Shkolla e Artit Pamor një muaj nuk ka punuar. Ka pasur skandal me ekskursionin e maturanëve. Për të gjitha këto raste asnjë fjalë nuk e keni thënë.

Mirëpo kulmi i të këqijave është rasti tragjik i një maturaniti i cili e ka humbur jetën, kurse ju asnjë fjalë nuk e keni thënë. Kultura, Rinia dhe sporti nuk ka çka të thuhet, sepse ajo që është ndërtuar për 15 vite e keni kthyer në nivelin zero. Këtë drejtori e keni anuluar me statut, kurse disa klube sportive janë shuar për shkak të mungesës së mjeteve. Flakën e Janarit e keni degraduar në atë masë sa që edhe familjarët e Dëshmorëve nuk kanë ardhur në “Flakë të Janarit”. Sa i përket punësimeve, ju i keni punësuar familjarët e juaj nga një e dy familjar brenda një viti. Ju keni prekur edhe te Hendiskosi, sepse ia keni ndaluar mjete drejtorit Remzi Kçiku, kurse Remziu është detyruar ta lëshojë Kosovën së bashku me fëmijët. Inspeksionin fare nuk e përmendni në raport thuaja se nuk ka ekzistuar fare. Të mundoheni t’ i fshihni këto të palara që kanë ndodhur brenda një viti, unë vetëm këtu po e shoh. Në vijim të fjalës së tij z. Nevzadi pati edhe vërejtje përkitazi me projektin e Kompleksit të Shkollave të Mesme i cili projekt është shkatërruar nga një ndërtim afër Gjimnazit. Në këtë mënyrë më 2007 është shkatërruar

“Dardania”, objekti afër Spitalit Regjional, mandej objektet te Dheu i Bardhë etj. Mua më vjen keq për këto skandale, por këto kanë ndodhur dhe ju lus që këto vërejtje mos të mbesin në vesh të shurdhër.

Në përfundim z. Nevzadi pati vërejte edhe në Zyrën e Informimit, sepse kjo zyrë nuk i publikon asnjëherë vërejtjet e opozitës, sepse çdo informatë së pari kontrollohet nga Shefi i Zyrës pastaj publikohet në medie.

Gjithashtu, z. Nevzadi theksoi se në Zyrën e kryetarit ka njerëz të punësuar pa asnjë letër dhe dokument i cili zyrtar qarkullon me veturë zyrtare për pa e pasur asnjë dokument.

Për mua ky nuk është raport i punës njëvjeçare, por është vetëm një dëshirë e kryetarit.

Selami Xhemajli- ne si AAK, mendojmë se është një raport gjithëpërfshirës, profesionalisht dhe teknikisht mirë i përgatitur me të dhëna të detajuara për çdo drejtor dhe për çdo sektor të administratës. Në raport ka shumë elemente pozitive e sidomos përkitazi me borxhet e trashëguara dhe shlyerjen e atyre borxheve, nënshkrimi i kontratave të ndryshme me operatorë etj. Menaxhim pozitiv dhe i avancuar është menaxhimi i mirë buxhetit, sepse buxheti është shpenzuar në masë prej 93%. Shpenzimet kapitale brenda këtij buxheti në vlerën prej 18%, pjesëmarrja në buxhet nga të hyrat vetanake në masën 18.25 %, inkasimi i të hyrave vetanake në masën 97%, janë elemente se po krijohet një mentalitet i ri qeverisës me të cilin hap po kthehet besimi i qytetarëve në qeverisjen e pushteti lokal të Gjilanit. Ne si pjesë e koalicionit qeverisë në dy drejtoritë tona jemi të kënaqura me punën e tyre, por është edhe meritë e kryetarit, sepse iu ka dhënë hapësirë e mjaftueshme që në bazë të ligjit dhe kompetencave që i kanë, kanë pasur hapësirë të mjaftueshme për t’ i kryer ato përgjegjësi që janë të parapara me ligj dhe të jenë kreativ në kryerjen e përgjegjësi të tyre. Mirëpo ne presim që këtë vit në drejtori dhe sektor të caktuar të rritet aktiviteti dhe angazhimi në funksion të kryerjes së punëve dhe detyrave. Mirëpo me reformatim dhe riorganizim si në Inspeksion dhe te rinia dhe sporti pasi që një kohë ka pasur ngecje, këtë vit duhet bërë përpjekje më të mëdha në mënyrë që edhe kjo drejtori të funksionojë ashtu si duhet dhe të ketë rezultate më të mira gjatë këtij viti. Unë në emër të grupit të AAK-së , kërkoj që të aprovohet Raporti i punës së kryetarit.

Nevzad Isufi – Të nderuar anëtarë të Kuvendit, Kryetar, zv. Kryetar, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të OJQ dhe të pranishëm të tjerë, jemi ne muajin mars të vitit 2015 dhe si duket u bë mjaftë e vështirë që të zëmë hapin e humbur dhe detyrat tona t'i kryejmë me kohë. Keq e patëm filluar vitin 2014, sa i përket raporteve, prej këtyre raportimeve jashtë çdo afati po arrijmë që të shqyrtojmë raportin vjetor të punës së Kryetarit dhe ekzekutivit me tre muaj vonesë edhe në këtë vit. Sa më shumë që humbin kohën duke u marrë me të kaluarën, ia pamundësojmë vetes që të merremi me të tashmen dhe të ardhmen dhe si rezultat do të kemi zvogëlimin e efikasitetit në kryerjen e të gjitha punëve.

Megjithëse nuk ka shumë kohë që kemi analizuar raportin nëntëmujor të punës së Kryetarit dhe qeverisë komunale, është e kuptueshme që shumë vërejtje të dhëna për periudhë e tre mujorshëve edhe më tutje qëndrojnë, dhe për të mos marrë kohën e çmuar të gjithëve nuk do t'i përsëris, por do të përpiqem të përqendrohëm në atë që ka ndryshim në këtë raport përfundimtar të vitit që lamë pas.

Në dukje të parë kemi një raport më të kompletuar, krahasuar me raportin e fundit me ç'rast mungonin raportet nga shumë njësi tashmë të krijuara ndërsa tash i kemi edhe ato.

Pozitive është megjithatë që më në fund, pas mospajtimeve të mëdha pozitive, opozitive, rreth borxheve të komunës mospajtimeve rreth shifrave, është bërë më në fund një përcaktim më saktë i këtyre borxheve dhe kjo është një gjë e mirë, por e keqja mbetet e madhe edhe më tutje për shkak se këto borxhe edhe më tutje mbeten pothuajse baras me të hyrat vetanake në buxhetin total të komunës, pa llogaritur këtu detyrimet kontingjente, të cilat në bazë të raportit janë mbi 2 milion e 903 mijë euro. Po ashtu, as kësaj radhe nuk e kemi specifikimin e borxheve të paguara gjatë këtij viti.

Nëse shifrat janë të sakta në raport, po thuhet se inkasimi i të hyrave vetanake për vitin 2014 ka qenë 3.698.329,51 euro, dhe në bazë të tabelës po thuhet se në raport me vitin 2013 paska ngritje prej 12.44%, gjë që është e mirë krahasuar me standardin gjithnjë në rënie të qytetarëve. Por nëse krahasimi është bërë saktë, mua në bazë të krahasimit të tabelave të vitit 2013 ku thuhet se realizimi ka qenë 97.84% kurse në vitin 2014 është 112.44%, del se dallimin duhet të jetë 14.6% e jo 12.44%, ju lutem më korrigjoni nëse e kam gabim. Pra shikuar nga ky aspekt më duket një shifër inkurajuese.

Ajo që besoj ta dëshironin të gjithë është që të kemi është zhvillimi ekonomik, por edhe nga raporti duket e thuhet se jemi ende në fazën e promovimit të tij, kështu që qytetarët ende nuk po shohin dhe prekin diçka konkrete. Nuk dua të paragjykoj as takimet me vendorë as me ndërkombëtarë, as takimet me organizatat si GIZ, Bankën evropiane e Bankën gjermane por frytet e këtyre bashkëpunimeve ndoshta pritët të shihen në të ardhmen.

Më poshtë thuhet "projektet e realizuara", unë mendoj se këtij togfjalëshi duhet shtuar fjalën "në letër" sepse realisht nuk kemi asgjë të konkretizuar. Përndryshe të gjithë do të shihnim parkun e lagjes Dardania I, nëse do të ishte realizuar, sepse sipas raportit thuhet "projekt i realizuar".

Po kështu qëndron puna edhe me projektet me partneritetin publiko-privat, ku projektet janë ende në fazën e fizibilitetit e ku përmenden ndërtimi i çerdhes "Dardania", palestra e sporteve, transporti publik, shkolla e mesme bujqësore "Arbëria".

Mendojmë që punë e mirë është bërë me panairin dhe regjistrimin e bizneseve, ndonëse kryesisht kemi të bëjmë me biznese të vogla, sepse kështu del nga përqindja e të punësuarë.

Në pjesën e shëndetësisë, arsimit dhe kulturës, ndonëse me të drejtë është vënë si parësore mirëqenia e familjeve në nevojë e ndihma në barna nga lista esenciale dhe ndihmat ndaj familjeve të dëshmorëve, nevojat shumë të mëdha por shumë janë tejet simbolike. Mendojmë se te pjesa e ndihmave familjeve në nevojë me dru të 315 familjeve, masën prej 2 metrash dhe në ndihmën 400 familjeve me ndihma në pako higjienike dhe ushqimore, mungojnë vlerat e këtyre ndihmave në euro.

Lidhur me pjesën që ka të bëjë me arsimin, ndonëse të dhënat janë tejet të përgjithësuara, por bazuar në faktin jo shumë larg nga kjo seancë, pra dy seanca më parë është biseduar e debatuar, ne kemi dhënë qëndrimin tonë të bazuar dhe mbrojmë ato qëndrime, ndonëse kohëve të fundit mendojmë se kemi një degradim për sa i përket udhëheqjeve, emërimeve e çemërimeve, transfereve dhe punësimeve pa konkurs, duke shkelur ligjet dhe anashkaluar procedurat, e ç'është më shqetësuese pa pasur

parasysh veçanërisht interesin e nxënësve por edhe të mësimitdhënësve, e krejt kjo shkon në dëm të ruajtjes dhe ngritjes së cilësisë së arsimit, të cilën të gjithë po themi se e dëshirojmë.

Edhe për sa i përket kulturës, me gjithë buxhetin e limituar, mendojmë se ka mundur të bëhet me shumë e në veçanti në realizimin më cilësor të manifestimeve të mbajtura, e sidomos pa maturi është ndërhyrë në fizionomitë e këtyre manifestimeve, si p.sh. në Flakën e Janarit, gjë që me të drejtë ka zgjuar reagime më të gjera të qytetarëve dhe në forma të ndryshme. Edhe për këto ne jemi shprehur kritik edhe këtu në Kuvend edhe në format tjera publike.

Në një masë të përafërt kritik kemi qenë edhe në përkushtimin dhe ndihmën e subvencionet e vogla ndaj sportistëve, klubeve shoqatave, ca prej të cilave janë buzë shuarjes. Një gjendje më e mirë nuk është edhe sa i përket infrastrukturës së sporteve, ku mungojnë sallat,(mirëmbajtja, ngrohja) rekuizitat sportive e shumëçka tjetër. Duke ditur se në këto aktivitet përfshihen kryesisht të rinjtë, kjo do të favorizonte më shumë talentet e rinj dhe do të shkonte në dobi të përfaqësimit më të mirë të sportistëve tanë edhe në pjesëmarrjen në garat kombëtare e ndërkombëtare, pasi që tashmë në fusha të ndryshme të sportit ndërkombëtar dyert janë të hapura edhe për Kosovën. Po kështu ndikim do të kishte sigurisht edhe në ndaljen e emigrimit të rinjve, dukuri kjo tejet shqetësuese kohëve të fundit, si në komunat tjera ashtu edhe në komunën tonë.

Për sa i përket urbanizmit dhe infrastrukturës besoj se pajtoheni edhe ju se ka shumë për t'u bërë, sepse jemi larg zgjidhjeve të kënaqshme dhe të mjaftueshme, sepse në shumë projekte infrastrukturore kemi ngecje dhe punë të tjera të pafilluara.

Po të shikohet nga informatat e këtij raporti, del se punë të mëdha po bëhen në përpilimin e planeve dhe projekteve rregulluese të hollësishme për disa zona të qytetit, të cilat edhe po të bëhen në formën më të mirë, do të mbesin ashtu në letër të pazbatueshme siç po mbesin edhe planet dhe projektet e planet rregulluese të mëhershme, nga se në terren mbeten të pazbatueshme e që nënkupton një harxhim të kot të kohës mundit e parave.

Pra, urbanizmi ynë i ngjanë një mini qeverie jofunkionale së cilës nuk i funksionon ekzekutivi (nënkupto me ekzekutiv inspeksionin). Pra, deri sa në zyra bëhen projektet, në terren ndërron gjendja nga çasti çast, prandaj nuk është e vështirë të merret me mend se sa të zbatueshme dhe të qëndrueshme mund të jenë të gjitha këto plane rregullative, në të cilat janë investuar jo pak mjete të buxhetit.

Nëse për urbanizmin qenka sfiduese procesi i hartimit të regjistrave të objekteve pa leje,sepse vërtet ato janë shumë, vetëm prej afatit të kërkesave për legalizim kanë arritur mbi 6500, nuk dihet saktë, por ky numër sipas kësaj dinamike të deritashme mund të dyfishohet e trefishohet, ku mbeten sfidat tjera. Por për këtë përgjegjësinë e ka ekzekutivi dhe Kryetari, të cilët për mendimin tonë kanë marrë hapa të gabuar, të nxituar e të pa planifikuar mirë, duke shuar inspeksionin dhe si rezultat i kësaj, sfidat vijnë njëra pas tjetrës dhe efektet e pafavorshme janë të prekshme edhe për këtë periudhë të shkurtër të riorganizimit që ju keni bërë. Në raportin e administratës u tha që janë punësuar 10 shërbyes civilë, për mendimin tone, më mirë do të ishte që së paku gjysma e tyre të punësoheshin në inspeksion, se sa të kemi gjendjen e tanishme, ku nuk kemi fare inspektorë të ndërtimit, ose edhe ispektorë tjerë, sepse të gjithë paguhen nga i njëjti buxhet, në të kundërtën ata me punën e tyre do të sillnin aq të ardhura sa të për t'u shpague mundi i tyre, madje do ndikonin në gjenerimin e të ardhurave edhe më të mira për urbanizmin e në anën tjetër, do kishim shkallë më të lartë të respektimit të ligjit të ndërtimeve, nga të cilat do të kishim përfitim të gjithë qytetarët.

Lidhur me ndërmarrjet publike si kompani, për sa janë funksionale do të duhej të kishim ndonjë raport më të saktë nga komisionet e formuara, se çfarë është punuar dhe sa janë aprovuar masat e propozuara nga ato. Gjithsesi punë e mirë është bërë me ndërrimin e gypit kryesor të ujit që është realizuar nga bashkëpunimi i Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe Hidromoravës, por duhet menduar edhe për pjesën tjetër të rrjetit, i cili arrin deri te gypi kryesor, sepse vetëm atëherë ai do të jetë plotësisht funksional.

Bashkëpunimet çfarëdo qofshin ato, do të duhej të sillnin diçka të dobishme edhe për qytetarët, po besoni se përpos këtyre fjalëve, qytetarët deri më tash, nuk kanë identifikuar ndonjë ndryshim nga gjendjet e mëhershme. Për transparencën e kemi thënë edhe më herët, por po e përsërisim se ajo nuk

është e tillë çfarë e raportoni. Takimet me qytetarë janë bërë sa për të përmbushur një detyrim ligjor, por pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë e zbehtë, prandaj edhe nuk përmendet asnjë propozim që ka dalë dhe është marrë parasysh si rezultat i debatit me qytetarë. Komuna jonë ka lokalitete të mëdha, ato ballafaqohen me probleme të ndryshme dhe ata duhet takuar, ashtu siç nuk keni hezituuar t'i takoni gjatë fushatës zgjedhore.

Shikuar përgjithësisht, ky raport në krahasim me atë të tre muajve me herët, është më i kompletuar, ndonëse është shërbyer me të dhënat e njëjta, por të modifikuara dhe i është shtuar edhe raporti për disa njësi, për të cilat më parë nuk kemi pasur raport, ndërsa tash kemi. Edhe tash si edhe herën e kaluar, aty ka nuk ka pasur diçka për të raportuar, është folur rreth planeve në të ardhmen, gjëra që më parë janë të përcaktuara në planifikim e nuk ishte dashur të përfshihen as në raport. Ne sektorin e kulturën, si edhe herën e kaluar nuk kemi asnjë fjalë për teatrin, sikur ai të mos ekzistonte fare. Nga zyra e informimit nuk kemi transparencë të duhur, sepse përpos lajmërimit në vebfaqe për seancat e Kuvendit, të cilat janë të hapura, duhet të kemi edhe fletë lajmërimi për seancat e Kuvendit në vendet me të frekuentuar të qytetit, kërkesë kjo e bërë edhe me herët, por që nuk është përfillur. Po ashtu në faqe të komunës do të duhej lajmëruar edhe për mbledhjet e komiteteve, nëse duam të jemi me transparentë dhe që edhe qytetarët të mund të marrin pjesë në to. Të dhënat për zyrat dhe njësitë janë një risi dhe plotësim në krahasim me raportin e kaluar nëntëmujor, dhe kjo bënë që ky raport të jetë më i kompletuar në aspektin e gjithëpërfshirës. Por ajo që i mungon këtij raporti, ashtu si edhe të kaluarit është doza e vetëkritikës, qoftë edhe në masën më të vogël, ndonëse vazhdimisht ankohemi në buxhet të pamjaftueshëm e të limituar. Në anën tjetër të gjithë jemi të vetëdijshëm, se këto kufizime bëjnë që shumë punë të mbesin në gjysmë, ca të tjera të pa filluara, ca të pa përfunduara, madje ndonjë edhe mund të dështoj fare. Pra siç po thuani edhe vetë ju, e kemi hallin e borxheve të mëdha të pa shlyera, ndërsa për ato të shlyerat, as edhe kësaj radhe nuk kemi shpjegime se kujt i janë shlyer, kur, në ç'shuma. Pra duhet të jeni të hapur- transparent jo vetëm me anëtarë e Kuvendit por edhe me qytetarët, sepse parat janë të tyre.

Bajram Hasani- i nderuari kryetar pas më shumë se një vit të qeverisjes së juaj, ju jeni arsyetuar deri më tani ndaj qytetarëve të Gjilanit se pushteti i kaluar ka lënë borxhe shumë dhe keni pasur probleme në menaxhim të financave. Unë edhe pse kam qenë në subjektin politik të PDK-së kam qenë një zë kritikues brenda qeverisjes së kaluar. Mirëpo iu bëj me dije juve edhe qytetarëve të Gjilanit se PDK ka lënë projekte mjaft të mira e të cilat duhet të vazhdoen dhe të përfundohen. Ju e dini se unë e kam mbështetur ndryshimin e statutit të Komunës me qëllim që t' i epet mundësi që ju ta krijoni modelin qeverisës tuaj edhe pse nuk kam qenë plotësisht në pajtim për plotësim dhe modifikim të Statutit të Komunës. Ne tash e dimë se kryetari i Komunës harxhon energji mjaft në politikat rehabilituese brenda LDK-së në të cilën në kohë të fundit ka mjaft përçarje. Unë nuk do të ndalem shumë në numra, por edhe nuk më intereson ajo se ku banon kryetari? Unë dëshiroj që punën ta bëjë në Gjilan, kurse të banojë kudo që dëshiron brenda territorit të Kosovës. Tash ka ardhur koha që qytetarët e Gjilanit kërkojnë punë dhe projekte konkrete, sepse u tha nga kolegët e LVV se disa punë që thuhet se janë realizuar ato ende nuk janë as në proces iniciues. Ne si subjekt Nisma për Kosovën, tani kemi formuar komisione adekuate për drejtoritë përkatëse dhe unë i premtoj qytetarëve dhe elektoratit të subjektit tim se ne do ta mbikëqyrim KK, duke dhënë kritika aty ku duhet, por do të japim edhe këshilla për modelin e qeverisjes. Nuk do të jemi çdo herë kritikues, por aty ku mund të kontribuojmë dhe ku është e mira e qytetarëve të Gjilanit, ne do ta japim kontributin tonë. Unë jam anëtar i Komiteti për Planifikim, por këto ditë kemi mbetur pa kryesues, sepse z. Murat Hoxha, tash është deputet i Kuvendit të Kosovës, prandaj kërkoj nga kryesuesja që sa më parë të zgjedhe kryetari i këtij komiteti për të qenë sa më funksional ky komitet.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- z. Nevzadi, sa i përket transparencës, KK i Gjilanit është shpallur një ndër kuvendet më transparente në Kosovë, ndërsa sa i përket njoftimeve për seancë, ndoshta nuk e keni parë një pano e cila gjendet në hyrje të Administratës komunale, por ka edhe në vende të tjera.

Lutfi Haziri- unë e kam për obligim që të kthej përgjigje ndaj grupit të anëtarëve të Kuvendit, mandej edhe drejtorët nuk mund të jenë të hendikepuar, sepse pasi që janë përmendur shumë projekte, ata do t'i japin

sqarime për secilin sektorë. Unë pajtohem me qëndrimin të cilin e paraqiti z. Nevzad Isufi i cili i ka dhënë të gjitha vërejtjet të cilat i kam thënë në 6 mujor, por ky raport njëvjetor pasqyron profilin dhe mënyrën e punës që e ka kryetari i Komunës. Është një dallim të cilin nuk po mund ta pranojë edhe më tutje nga një numër i grupit të PDK-së. Dallimi është se unë aplikoj sistem të delegimit të punëve të dekoncentruar në zyrë dhe nuk ka sistem të centralizuar të punës si ka pasur gjatë viteve të kaluara. Ky është një dallim i madh i cili e pasqyron edhe modelin e punës, por unë nuk kam hyrë në detaje dhe nuk kam tentuar ta bëjë një raport voluminoz sa për të pasur një efekt psikologjik. Dikujt po i duket problem i vogël borxhi, por ne 1.2 milion €, i kemi investuar vitin e kaluar, por po t' i kishim pasur edhe 2.6 milion €, investime dhe po mos të kishim pasur borxhe, Gjilani me të vërtetë do të kishte pamje tjetër. Unë po pajtohem se nuk po shihen efektet edhe më tutje, nuk po shihen, sepse kam vendos për ta bërë servisimin e borxheve që nga dita e parë si logjikë të punës. Nuk e kam ndërmend ta bëjë një politik hakmarrëse dhe revanshiste, por logjikë pune. Unë kërkoj që obligimet të shlyhen pavarësisht mënyrës se si janë shkaktuar dhe unë këtu nuk i kam kategorizuar borxhet e këqija! Unë definitivisht nuk dua më të merrem me të kaluarën, por edhe këtë vit ka servisim të borxheve, por edhe vitin e ardhshëm do të ketë.

Unë e lus drejtorin për Financa që t' i shpërndajë të gjithë anëtarëve të Kuvendit pagesat prej 2.6 milion €, ndaj operatorëve dhe autoriteteve të cilat ne i kemi bërë në vitin 2014. Aty do ta keni mundësinë ta lexoni dhe shikoni se në çfarë mase dhe pse janë bërë? Nuk ka qenë desh Gjilani të vijë në këtë ditë, sepse ka qenë deshtë logjikshëm të fillojë servisimi i borxheve duke i përfshirë edhe borxhet e këqija të cilat nuk janë bërë në përputhje me ligjin. Është bërë fillimi i projektit pa zotim të mjeteve, është bërë fillimi projekteve pa procedura të prokurimit! Nuk janë pak 780 mijë euro borxh që figurojnë që nuk ka asnjë procedurë të prokurimit dhe nuk mund askush të krijojë borxhe më shumë se masa e caktuar me ligj. Nuk është bërë asnjë barazim në subvencione në 4 vitet e kaluara. Kjo është barrë e rëndë për një buxhet edhe ashtu i varfër. Unë kam arrit për ta përmirësuar buxhetin në tri kategori kryesore, në subvencione për bujqësi, investime kapitale dhe në programe që i kemi pasur problem sidomos në arsim. Sa i përket raporteve tjera nuk mund ta pranoj gjuhën mënyrën dhe tendencën për komprometim, por çdo këshillim dhe debat është e pranueshme për mua, por kur thotë kolegu edhe pas 15 muajve se kryetari nuk banon në Gjilan është tejet tendencioze. Tërë Gjilani e dinë se unë jam 5 ditë të punës në Gjilan dhe natyrisht fëmija mi janë në shkollë publike dhe nuk janë si fëmija dikujt në shkollë private dhe në shkollë jashtë shtetit. Do të dëshiroja t' i dërgoj fëmijët në shkollë private dhe në studime jashtë vendit, por ende nuk kam arrit në atë shkallë. Është e padrejtë si baba që ku shkon për të punuar t' i merr edhe fëmijët me vete!

Fëmijët e mi do të rriten dhe unë e kam për obligim për t' ia krijuar ndjenjën e pavarësisë dhe nuk mund mua askush të më mësoj se si do të sillem unë me familjen time. Kush nuk beson le t' i adresohet shefit të policisë i cili merret me sigurinë publike dhe ai është më i informuar se ku banoj unë. Ligji e thotë se kryetari i Komunës duhet të banojë brenda territorit të komunës së vetë dhe unë që nga dita e parë e kam respektuar ligjin dhe do ta respektoj. Stafi dhe shërbimi civil dhe shërbimet e tjera që ne i kemi nën menaxhim, ka një keqkuptim edhe në publik, sepse të gjithë punëtorët nuk janë nën autoritetin tim ekzekutiv. Kemi gjet probleme jashtëzakonisht të mëdha në sektorin e arsimit, sidomos te pagat. Një numër i madh i punëtorëve të arsimit është pranuar me konkurs, por iu është ndryshuar kontrata dhe kanë kaluar në kompani private. Ky numër i punëtorëve që është pranuar me konkurse publike, sipas ligjeve të Kosovës, duhet t' ia kthejmë statusin e tyre, por aktualisht nuk ka buxhet. Ne po punojmë në ndryshime eventuale, por për shkak mos lejimit të punësimeve ne kemi problem. Janë 9 zjarrfikës që marrin mjete prej neve, janë 12 punëtorë të arsimit të cilët kanë qenë me kontratë në vepër me Kompaninë e Sigurimit "Sas". Janë probleme të cilat janë akumuluar, por është fakt që kam filluar të kthej punëtorë në punë, por jo të pranojmë të tjerë. Shumica e punëtorëve që janë kthyer në vende të lira, janë punëtorë të cilët kanë qenë të pranuar me konkurs, por që atë drejtë e kanë humbur për shkak të lëvizjeve në kompani private. Qeverisja e ime për vitin 2014 është qeverisje e butë e aplikuar në raport me qytetarin, sepse unë e ruaj edhe më tutje qëndrimin se nuk ka komunë të pasur me qytetarë të varfër. Nuk ka masa të ashpra ligjore ndaj ndërtuesve të egër! Kjo nuk i amnistion ata, do të ketë, nuk ka masa të ashpra në inkasimin e borxheve të qytetarëve ndaj komunës, por veprime do të ketë. Ne do të organizojmë në përputhje me ligjin përmbarues në kategori të veçanta. Komunës nuk i kanë borxh qytetarët, por i kanë borxh subjektet, kompanitë dhe borxhlinjtë më të mëdhenj të Komunës janë operatorët. Masa më e vogël e borxhlinjve janë qytetarët, qoftë tatimi në pronë qoftë te taksat e ndryshme komunale. Ky është raporti qeverisje e butë, sepse nuk ka pasur masa të ashpra në vendosjen e një standardi, kërkesës, vendimi apo baze ligjore.

Reagime do të ketë rigorozë tash, sepse 54 ndërtues ilegal do të kenë problem, por edhe ndërtuesit e lartë do të kenë problem dhe nuk do të amnistohen as ata. Nuk ka pasur reagim të ndërtimit të shkollave e mesme, sepse është pronë private dhe për mua më e çmueshme është prona private në raport me çdo gjë tjetër. Nuk mund t' i

mohohet qytetarit nëse është pronë private dhe nëse ligji ia lejon të ndërtohet. Ligji me plan rregullativ ia lejon dhe unë nuk ndërhyj për t' i cenuar të drejtën për shkak të planeve që Komuna i ka në oborr të shkollave i cili është projekt i mirë definitivisht, por a realizohet apo jo do të vlerësohet edhe më tutje.

Këto janë të gjitha angazhimet që këtë pjesë të vitit 2014 e kanë karakterizuar, pjesën tjetër të kualifikimeve e marrë ashtu siç e thoni dhe ashtu siç e konsideroni thone, por po e thoni bile më ashpër me akuza dhe fjalor që në Gjilan është në kundërshtim me kulturën politike që është ndërtuar me vite. Unë po e theksoj se për një konflikt duhen dy vetë, por mua nuk më keni pjesëmarrës.

Duhet ta dini se kryetari i juaj nuk rrinë në zyrë kur nuk ka punë, vetëm kur ka punë angazhohem dhe punoj.

Në atë çast që nuk kam punë, unë dal jashtë zyrës dhe angazhohem, kjo është mënyra me të cilën unë punoj dhe kjo nuk është vetëm tash, sepse unë jam në mandatin e tretë me ju. Unë kam drejtor dhe stafin tim dhe me ata i koordinoj punët. Në fund po theksoj se raporti nuk i ka 5 faqe, por 35, prandaj duhet shikuar dhe lexuar mirë dhe me kujdes.

Bujar Nevzadi- unë e dëgjova kryetarin, por me disa gjëra nuk pajtohem. Sa i përket delegimit të kompetencave e që tha se janë bartur te drejtorët, por disa shkelje si te pranimit i kuadrit arsimor ka ndërhyrë zyra e juaj dhe mandej nuk është pranuar kandidati i parë, por ka shkuar i katërti.

Sa i përket kryerjes së obligimeve, kemi informata se po kryeni obligime në mënyrë selektive, po bëni ndarje! Mandej drejtori nuk e ka sjell në raport se kujt ia kemi shlyer borxhet dhe ndaj kujt kemi obligime?

Edhe sa i përket pronës private nuk pajtohem për rastin e shkollave të mesme, sepse prona private edhe nëse është e shenjtë, përsëri nuk mund të shkatërrohet plani i shtetit!

Sahit Abazi- raporti i kryetarit, është obligim që të raportojë dhe e mira e këtij raport për aq sa kuptoj unë në aspektin gjuhësor ishte mjaft mirë, por pat vetëm lëvdata nga kolegët e pozitës. Mirëpo raporti nuk përmend sfidat serioze të cilat i ka Komuna. Nuk përmenden ngecjet të cilat i theksoi Bujari, sepse kryetari i dha hapësirë të madhe shlyerjes së borxheve, por po e marrë si shembull zonjën Mimoza Kusari e cili po ashtu sikur z. Haziri e ka një shumë mjaft të madhe të borxheve të trashëguara nga mandati i kaluar, por ajo ia ka arrit që t' i tërheq së paku dy kompani serioze në komunën e saj. Çka e ka penguar kryetarin e Komunës ta bëjë një gjë të tillë, derisa ajo ka arrit t' i sjell dy kompani serioze për zhvillim ekonomik. Në Gjilan sa i përket zhvillimit ekonomik, fatkeqësisht nuk shohim ndonjë zhvillim pozitiv sa i përket fushës së ekonomisë gjatë kësaj qeverisje 15 mujore. Kemi disa ngecje shumë serioze në të cilat unë do të fokusohem në çështje praktike e të cilat janë të argumentuar lehtësisht. Si vërejtje serioze është se në Gjilan operojnë taxi pa leje nga Ferizaj, Vitia dhe Dardana e që me siguri kryetari ka marrë vërejtje nga operatorët legal. Këta taxi të egër nuk i pengon askush e cila dukuri nuk po ndodh vetëm sot, por gjatë tërë mandatit 15 mujor të z. Haziri.

Sa i përket ndërtimeve pa leje për 15 muaj asnjë rrënim i objekteve pa leje nuk ka ndodhur! Duke mos e rrënuar asnjë objekt po krijohet klima për t' i vazhduar ndërtimet e tjera pa leje. Tash është duke u folur se mund të legalizohen objektet, por nuk duhet të ketë legalizim të objekteve të cilat tash po ndërtohen pa leje.

Në Gjilan kemi ndërtime pa leje dhe te Xhamia e Vogël, ka objekte të ndërtimeve të larta pa leje dhe pa pëlqim urbanistik. Raste të tilla ka prapa Stacionit të Autobusëve, në Arbëri, te rruga e Prishtinës ka objekte të dukshme pa leje etj. Në sajë të neglizhencës së kryetarit dhe mos kushtimit të rëndësishëm për Drejtorinë e Inspeksionit është krijuar një bindje se ndërto sa të dëshiron, kush të dojë, sepse askush nuk merret me këtë çështje!?

Z. kryetari nuk i përmendi çështjen e deponive të egra, sepse gjatë këtij mandati ky numër i deponive veç është rritur dhe Lumi i Livoçit të Epërm është i tmerrshëm për sytë e njeriut kur sheh se tërë ky lumë është shndërruar në deponi të mbeturinave. Te kolektori afër Zabelit është një kaos i vërtetë e që këto dukuri negative dhe të shëmtuara nuk përmenden dhe nuk thuhet se janë disa sfida me të cilat do të përpiqemi që t' i eliminojmë. Një kërkesë e cila është urgjente e cila nuk ka të bëjë shumë me raportin, por sot mora lajmin se Hendikosi e ka mbyll zyrën, sepse iu është ndërprerë rryme për shkak të mungesës së mjeteve, prandaj unë sot kërkoj që te kjo OJQ të alokohen mjete, sepse ata nuk kanë mundësi të funksionojnë dhe dihet se çka do të thotë të mos funksionojë Hendikosi. Ftoj kryetarin e Komunës që për këto që i përmendëm ta bëjë një agjendë të re pune, një plan pune për t' i zgjidhur këto probleme dhe ne nuk jemi këtu për ta ashpërsuar gjuhën e kritikës, por jemi për t' i thënë këto që i thamë. Të bëhet një plan serioz që ka të bëjë me tërheqjen e investimeve të huaja dhe jo si ajo qasja e juaj fillestare për t' i ngarkuar bizneset me taksa komunale e të cilat i ka heq pushteti i PDK-së në mënyrë që të krijohet një klimë e favorshme e biznesit. Në Gjilan për 15 muaj nuk e kemi asnjë investitor serioz të cilin do t' ia atribuonim kësaj qeverisje, por përkundrazi e kemi një regres dhe pasojat do të jenë të mëdha.

Fehmi Sylejmani – do të ishte shumë e pandershme, po të mos thuhet se në këtë raport, përkatësisht gjatë kësaj qeverisje njëvjeçare nuk ka shenja të progresit. Po e vërtetë, ka a më shumë është vështirë të numërohen disa gjëra pozitive, që mbase edhe u thanë, mirëpo janë shumë pak krahasuar me evidentimin e defekteve që e kanë përshkruar këtë qeverisje gjatë këtij njëvjeçari. Po ua numërojmë mangësitë e kësaj qeverisje:

Premtime boshë, e shumë pak apo aspak realizime

Asnjë projekt i madh nuk ka përfunduar gjatë vitit 2014 në Gjilan

Nuk ka investime të huaja

Janë realizuar vetëm 18 % të premtimeve të kryetarit, kjo e dhënë është sipas GAP-it

Parregullsi në punësim, tenderim dhe realizim të projekteve

Ndërtime të shumta pa leje

Nuk ka plane urbanistike në tërësi

Ka devijime të planeve urbanistike

Mungesë e transparencës dhe sundimit të ligjit

Po manipulohet me borxhin e komunës

Fare nuk është punuar në shtratin e lumit Mirusha, Varrezat e Dëshmorëve, dhe Bibliotekën

Udhëtime të shpeshta dhe të panevojshme të kryetarit jashtë vendit

Mungesa e llogaridhënies për këto udhëtime

Vendime të dëmshme, të kundërligjshme dhe selektive që e kanë rënduar jetën e qytetarëve

Emërimet e drejtorëve jo profesional

Emërimet e u.d edhe më tej vazhdojnë

Mungesë të rregullimit të infrastrukturës dhe kanalizimit,

Politizim e jo depolitizim të arsimit,

Mungesë mbështetje për klubet sportive,

Mungesë mbështetje për kulturën dhe rininë

Mungesë të krijimit të parqeve, kopshteve dhe gjelbërimeve

Mungesë e ndriçimit publik,

Nuk ka zgjerim të rrugëve,

Mungesë mbështetje të bujqësisë,

Nuk ka ngritje të cilësisë së shërbimeve mjekësore

Mungesë e disa barnave më esenciale

Shuarja e dy drejtorive- dështim total

Mungesë të përfaqësimit të gruas në ekzekutiv

Defekte të mëdha në sektorin e arsimit

Shkelje të dispozitave ligjore

Rritje e papunësisë dhe varfërisë

Jo kujdesi i merituar për familjet e dëshmorëve, veteranëve dhe invalidëve të luftës

Keqpërdorim i manifestimit tradicional “Flaka e Janarit”, lirisht le të thuhet Flaka e LDK apo

Flaka e L.Hazirit.

Kryetari Haziri gjatë tërë kohës sa ishte në opozitë, vazhdimisht pohonte se Gjilani është në depresion politik dhe ekonomik. Edhe pas një viti të qeverisjes së tij, Gjilani veç sa është thelluar edhe më shumë në këtë depresion, shkak i paaftësisë për të udhëhequr drejtë dhe mirë këtë komunë, ashtu siç e meritojnë qytetarët gjilanas, sepse këta qytetarë vërtetë dëshmojnë një qeverisje të mirëfilltë dhe të pa korruptuar.

Po ashtu kishte deklaruar se qeveria ose duhet t’i paguaj borxhet ose borxhin do ta paguaj vetë, sepse nuk ka hy me autoritetin e saj të ndal këtë trend, andaj ajo ka hy në obligime dhe është bashkëborxhli e Ministria e Financave është pjesë e barabartë në këto borxhe që janë krijuar në komunën e Gjilanit. Kështu patët deklaruar z. Haziri, në fillim të mandatit tuaj. A mendoni edhe më tej, se qeveria duhet

të jetë bashkë borxhli. Po ashtu z.kryetar në fillim të mandatit të tuaj patët paralajmëruar se “do ta udhëheq komunën me lak në fyt, ngase borxhet që po i trashëgoj janë tetë milionë euro, andaj keni paralajmëruar një auditim të pavarur për të konstatuar ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e këtij konstatimi financiar. Këtë komision të auditimit, tërë kohën z. kryetar, anëtarët e LVV në këtë kuvend e kanë kërkuar, por akoma nuk kemi asnjë një raport zyrtar rreth kësaj kërkesë dhe këtij paralajmërimi të Juaj.

Me plotë të drejtë qytetarët anekënd komunës pyesin dhe kërkojnë projekte reale e praktike, investime, zhvillim, prosperitet, mirëqenie më të mirë, punësime sa më objektive dhe më të vëllimshme, e jo premtime boshe, jo regres, jo depresion politik e ekonomik, jo mashtrime e trillime, e aq më pak gënjeshtër, sepse vërtetë qytetarët tashmë një kohë të gjatë janë lodhur, jo vetëm me këtë qeverisje, por edhe me të tjerat para saj, duke e humbur shpresën për një jetë më të mirë në këtë vend.

Arben Maliqi- e shfrytëzoj rastin për ta falënderuar kolegen për të arriturën shkencore, kurse Jakup Bajramit i uroj për të tretë herë mandatin e anëtarit të Kuvendit.

Unë mendoj se raporti i kryetarit është një raport i thuktë dhe përmbajtësor, sepse i ka prekur të gjitha gjërat kryesore apo relevante të sektorëve komunal. I urojmë projektet e realizuara me organizatat ndërkombëtare të cilat kanë qenë shumë të nevojshme për Komunën tonë si është ndërtimi i parkut në lagjen “Dardania” në të cilin projekt pritet edhe zbatimi në muajin mars ose prill. Mandej zhvillimi ekonomik lokal i bujqësisë e që janë projekte për të cilat ka pasur nevojë Komuna e Gjilanit. pastaj reforma e re në arsim ka kuptuar edhe heqjen e disa klasave, por e dimë shumë mirë se ka qenë një sfidë për kryetarin e Komunës dhe drejtorin e Arsimit të lihen të papunë afër 70-80 punëtorë arsimor. Mirëpo është gjet një model dhe të gjitha ata punëtorë arsimor janë, sistemuar dhe kjo është një meritë shumë e madhe. Rregullimi dhe asfaltimi, arnimi i rrugëve në të gjitha pjesët e qytetit ka ndodhur pa dallim bindje politike dhe lagjeje dhe pa dallime familjare, kjo ka ndodhur në të gjitha cepët e Komunës. Mandej i kemi ndërmarrjet e Komunës të cilat funksionojnë në mënyrë përfekte duke u nisur nga ndërmarrja publike “Eco –higjiena” dhe “Hidromorava”.

Mandej rritja dhe bashkëpunimi me komunat ndërkufitare si dhe themelimi i Zyrës për Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc është një e arritur e madhe, sepse nuk i kemi harruar vëllezërit tanë. Bashkëpunimi me Policinë, me KKSBB-në, departamentin e drejtësisë, KFOR-in etj janë në nivelin e duhur. Mirëpo shtrohet pyetja a ka vend për vend vetëkënaqësi? Unë mendoj se jo, por duhet të fokusohemi dhe me një punë jashtëzakonisht të madhe në bashkëpunim me të gjithë neve që t’ia arrijmë qëllimit. Është me rëndësi që t’i përfundojmë të gjitha projektet të cilat kanë filluar edhe në pushtetin e kaluar, sepse unë e di që ka shumë projekte të cilat kanë mbetur për ndonjë arsyeje, por kryetari së bashku me strukturat e veta duhet t’i kryejë ato projekte? Agjenda e kryetarit duhet të jetë në fushën e arsimit dhe sportit. Sa i përket sportit pritet që shumë shpejtë të pranohen edhe disa federata të sportit në familjen evropiane, prandaj duhet t’i kushtohet një rëndësi e veçantë, mandej inspeksionit, shëndetësisë etj. Presim ditë edhe më të mira dhe shpresojmë se subvencionet dhe investimet kapitale të kthehen në Komunën e Gjilanit. jemi të vetëdijshëm se Komuna e Gjilanit deri më sot ka qenë zorrë qorre, por ne besojmë në autoritetin e kryetarit dhe të gjithë atyre deputetëve pa dallim bindje dhe partie politike që sa më shumë të ketë projekte kapitale në komunën tonë.

Fatbardhë Selmani- unë do të ndalem tek raporti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në të cilin raport janë përmendur disa të arritura të cilat nuk janë aq të konkretizuara si duhet. Unë do t’i ceki disa dështime të cilat nuk janë përmendur nga kryetari. Në këtë raport për Drejtorinë e Shëndetësisë thuhet kështu: “ edhe në mjekësinë primare, por edhe në mjekësinë sekondare janë bërë punë të mira, janë ofruar shërbime mjekësore gjatë 24 orëve dhe gjatë 7 ditëve të javës. ..” Do të theksoj se në këtë mënyrë fillon mashtrimi ndaj qytetarëve.

Shumë qytetarë e dinë e sidomos nga fshatrat është dashtë të udhëtojnë disa kilometra nga fshatrat deri në qytet për ta marrë një shërbim shëndetësor, sepse QMF nëpër fshatra nuk kanë funksionuar. Këtë që po e them në fund e vërtetoi edhe anëtar i juaj i Kuvendit nga fshati Zhegër. Mashtrimet e qytetarëve vazhdojnë, sepse furnizimi me barna nga lista esenciale thuhet se ka qenë e mirë. Është trumbetuar mirë se opozita po shpif dhe po i përdor këto gjëra për qëllime mediatike. Nuk i kemi bërë kurrë dhe nuk do ta bëjmë, sepse ne flasim me

argumente vetëm për atë që e prek qytetari dhe pastaj të bindet. Tani del se me të vërtetë kanë munguar barnat nga lista esenciale dhe ju pushtetarë e keni sjell pacientin në një gjendje të mjerueshme nga keq menaxhimi i juaj!? Është thënë se vaksinimi është kryer sipas orarit dhe me kohë, por më vjen keq që duhet të përdor shprehje të cilat nuk i takojnë karakterit tim, por pse po gënjeni kur vetë zyrtari i Qendrës së Vaksinimit në një mbledhje të komitetit ka raportuar se disa nga vaksinat sipas kalendarit për vakcina mungojnë? Këto vakcina nuk kanë munguar për një muaj, por për disa muaj rresht. Me këtë vërtetohet se gjendja nuk ka qenë ashtu si ju po thoni, sepse për këtë ekzistojnë edhe shënimet. I njëjti rast ka qenë edhe furnizimi me insulinë, sepse shumë kohë nuk ka pasur insulinë e që është një gjendje shumë e rëndë për QKMF-në. Kjo gjendje e tillë nuk vjen nga dieta e aplikuar nga kryetari, por vjen nga keq menaxhimi i drejtorisë përkatëse. Është premtuar ndërtimi i QMF-ve, është premtuar numri i rritjes së stafit, por ju nuk keni mundur t' i mbani as ata që i kishit. Nuk mund t' i mbani të hapura shumë punkte nëpër fshatra. Për 8 muaj nuk mund ta zgjidhni një drejtor të drejtorisë, kurse në medie dilni dhe thoni keni bërë mirë, sepse e keni kursyer një rrogë të drejtorit. Ju e emëruar ushtrues detyre të njëjtin person që ishte edhe ushtrues i detyrës së drejtorit edhe në QKMF e që është konflikt i hapur i interesit. Në çdo reagim tonin ju heshtni dhe nga keq menaxhimi dhe lojërat që po bëni me drejtorë dhe ushtrues detyre sot shumë familje nuk e gëzojnë asistencën sociale! Këto fakte janë aq të paarsyeshme kur dikujt i epet asistencë sociale, kurse Komuna ta refuzojë. Kjo është e vërtetë dhe është e turpshme dhe këto raste nuk janë pak, por janë me dhjetëra, por ka raste shumë të rënda të cilëve nuk iu është njohur e drejta e asistencës sociale. Punë e mirë qenka bërë që Hendikosi nga 13 mijë e 500 € që i kishte të ndara për subvencione (për karburante) për vitin 2013, vetëm subvencione kishte 11 mijë euro, por në vitin 2014 kësaj OJQ ju i keni ndarë vetëm 5 mijë e 800 euro. Nga këto subvencione ishin 4 mijë euro edhe pse 2 mijë euro jeni betuar se para nesh se do t' i ndalni dhe ia keni ndal dhe ato mjete nuk janë në xhirrologarinë e tyre duke e ditur që kjo organizatë po shuhet. Kjo që po bëni ju me ata njerëz është e tmerrshme kur dihet se me të vërtetë vetëm një trajnim për ata njerëz ne kemi paguar sa i tërë subvencioni i juaj. Në kushte të njëjta vazhdon të punojë edhe OJQ e Shurdhmecëve e cila i ka marrë diku afër 1 mijë e 500 euro subvencion, kurse më e privilegjuar është OJQ e të Verbërve për arsye të cilën e di vetë kryetari. Nuk janë vetëm këto dështime të kësaj drejtorie, por është edhe dështimi i projektit i dezinfektimit dhe deratizimit e që ishte një nga dështimet më të mëdha të kryetarit. Dështimi tjetër ishte edhe kontrolli sistematik nëpër shkolla, sepse nuk ndodhi ky kontrollim në vitin 2014. Çdo konkurs i hapur për kompletim të stafit është i mangët, prandaj ju si kryetar komune desha t' i pyes se a jeni në njohuri se sa është numri i mjekëve të papunë? Ne kemi kërkuar që të na epet lista e subvencioneve të cilat janë dhënë, sepse ne nuk e kemi marrë asnjëherë listën me subvencione se kujt iu janë ndarë subvencione dhe sa mjete iu janë ndarë? Një gjendje e tillë të keqe e keni pasur edhe për ujin e pijshëm, sepse rrejt i ujësjellësit është i vjetruar dhe në disa vende është parë shija, ngjyra e ujit në gjendje jo normale.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- si zonjë, nuk është mirë të thuhet fjalë fyese dhe ofenduese, sepse ju duhet të jeni në femër që shërbeni si shembull për femrat tjera dhe jo vetë të ofendoni dhe fyeni në Kuvend anëtarët. Për fyerje të tilla do të merren masa.

Arben Mehmeti- së pari po theksoj se është duke u përdorur nga opozita një gjuhë e papranueshme, sepse edhe ne kemi qenë në opozitë, unë kam qenë shef i opozitës, por komunikimi me kryetarin ka qenë krejt ndryshe. Gjuha ka qenë parlamentare dhe me rregulloren në fuqi rregullohet kjo fushë. Është mirë që kenë kujdes në të ardhmen opozita dhe nuk duhet ta përdor një fjalor me rregulloren dhe me praktikën tonë. Kushdo që diskuton në këtë Kuvend nga opozita është mirë ta kujtojë rezultatit e zgjedhjeve, sepse dihet si ka qenë rezultati, por edhe dihen arsyet për atë rezultat. Ka qenë një keq menaxhim i madh në të gjitha fushat dhe nuk do koment kjo më tepër. Duhet pasur kujdes, të mendohet rezultati, pastaj të flitet diçka.

Sa na përket neve është periudhë e shkurtër dhe nuk mund të bëjmë mrekullira dhe ta ndryshojmë situatën nga e kaluar e cila ka qenë jo e mirë.

Sa i përket punësimit ne e dimë se çfarë punësimi kemi pasur në të kaluarën, sidomos të çështja e kontratave në vepër. Ka qenë një punësim përmes një organizate private nga e cila kemi rekrutuar punëtorë. Ata punëtorë i kanë pasur dy shefa e ka pasur dhe kryetarin e Komunës edhe një pronar nga një kompani private e cila vetëm po të shikohet lokali mund të kuptohet se çfarë anarkie ka qenë edhe kush ka pasur qasje në Administratën Komunale në qeverisjen e kaluar? Tash kushdo që rekrutohet dihet kush është udhëheqës dhe kjo është legale.

U përmenden shumë gjëra që nuk duhet të thuhet, u përmend Mimoza Kusari që nuk bëhet krahasim fare, sepse kjo zonjë është në një pari e cila ka vota sa një këshilltar komunal. Çështjen e deponive të egra e dimë si ka qenë në të kaluarën, sepse ne kemi jetuar në Gjilan dhe e dimë si kanë qenë të rregulluara deponitë e egra. Mandej kemi politizim të Hendikosit prej njerëzve që janë këtu prezent, pikërisht nga opozita. Ky është një politizim se gjëja ne kemi kujdes më shumë se opozita, por kjo nuk qëndron. Nuk ka progres nuk ka projekte i tha nga Fehmi Sylejmani i cili jeton në “Dardani”, por aty po shihen asfaltimet të cilat po ndodhin. Sa i përket udhëtimeve jashtë vendit, KK nuk e ka atë obligim për të matur raporte personale të kryetarit, por është edhe interes i joni që kryetari të jetë jashtë KK-së për të përfituar investime.

Riadin dhe Fatbardhën i kam parë se kanë dhënë disa informata me gazetarë për sportin e nxënësve i cili rast është keqpërdorim i pozitës zyrtare, sepse nuk ka të drejtë të merret asnjë parti politike të del dhe ta mbrojë interesin e dikujt tjetër në mënyrë jashtë institucionale. Unë këtu po ndërpres, por besoj se do të flas edhe më tepër e atëherë dikush duhet të hesht.

Fehmi Sylejmani- është mirë që ne të flasim shumë drejtë dhe parimisht, sepse edhe pse përfaqësojmë parti politike duhet të jemi korrekt. Me sa e di unë projektet në “Dardani” nuk janë projekte të kësaj qeverisje, por këto janë vazhdimësi e një qeverisje të mëhershme.

Riad Rashiti- unë vetëm po theksoj dhe duhet ta dijë se ne kemi filluar projekte e që në këtë qeverisje janë harruar në tërësi. Kështu ka ndodhur me Qendrën për Biznes dhe projektet e PPP-së. Ne jemi angazhuar dhe kemi rekrutuar punëtorë, kurse ju keni angazhuar punëtorë njësoj, vetëm e keni ndryshuar formën. Mirëpo ajo që është më e keqe raporti financiar dokumenton se kjo komunë ka paguar punëtorë përmes subvencioneve e që është shumë më e rëndë. Ne kemi paguar përmes mallrave dhe shërbimeve, kurse ju disa punëtorëve i keni dhënë pagë prej subvencioneve. Sa i përket deponive të egra z. Arben Mehmeti ne në qeverisjen tonë i kemi marrë shpërblim nga USAID-i 10 mijë euro për pastërtinë që e kemi krijuar në qytet në qeverisjen tonë. Ky nuk është vlerësim i joni, por është i USAID-it dhe nuk është mirë që ju thoni se gjendja është njësoj dhe ta hidhni poshtë kontributin e huaj e të cilët kanë financuar me mijëra euro për ta rregulluar këtë vend. Është mirë që ta respektoni punën e mirë të dhe shokët e tu, punën e mirë që qeverisjes së kaluar.

Sahit Abazi – për këtë që e tha Arbeni, unë e kam vetëm një fjali të vetme. Arben ti je zëdhënës i dobët i kushëririt të kryetarit të Komunes!

Fatbardhë Selmani- po i them z. Arben Mehmeti se gjuha e tij është ofenduese, sepse po i mungojnë argumentet përkatëse për t’i demantuar ato që i themi ne prandaj përdoret kjo gjuhë. Sa i përket Hendikosit dikush e përkrah më shumë e dikush më pak, por mund t’i merrni të dhënat dhe t’i krahasoni se sa e kemi përkrah ne dhe sa ju?

Me këto krahasime mund të shihet se ne nuk jemi që e politizojmë këtë OJQ.

Avdyl Aliu- po e filloj me një këshill për të gjithë kolegët këtu; “kur të dilni prej shtëpisë mos harroni për ta marrë moralin me vete”. Dikush po thotë në politikë nuk ka moral! Mirëpo bash në politikë ka moral dhe mu në këtë vend duhet të ketë moral. Jo moral të tepruar të dyfishtë, por një moral! Po më vjen mirë se i paskan bërë hajr koleges Fatbardhës subvencionet të cilat i ka marrë Fatbardha, herë 1 mijë, herë dy mijë, herë 500 euro.

Herë i ka marrë në emër të vetin, herë në emër të babait, të vëllait, motrës, apo ndoshta nga ndonjë kushëri. Unë po e them se me ato 1 mijë, 2 mijë dhe 500 euro, ia keni marrë parat Hendikosit dhe Shoqatës së të Verbërve, prandaj ata sot nuk kanë. Nuk do të thotë që nuk kanë e nuk do të kenë. Mirëpo po iu rikujtoj se kontratat e para që janë nënshkruar për subvencione prej kryetarit ka qenë Shoqata e të Verbërve dhe Hendikosi. Nga kjo shihet se kush është merakos shumë për Hendikosin?

Arben Mehmeti- unë do të isha i nderuar po të isha zëdhënës, në këtë rast i kushëririt, kryetarit të komunës? Mirëpo nuk jam. Ato që i thash janë fakte reale dhe nuk ka nevojë të më tregoj askush që nga periudha e pas luftës, sepse unë e kam mandatin e 4 në KK. Të më tregoj Sahit Abazi se unë jam zëdhënës për mua është skandaloze! Është skandaloze, sepse është i ardhur në politikë vonë. Ka ardhur nga keq menaxhimi i disa OJQ-ve duke i shërbyer ish pushtetit, tash ka ardhur në PDK. E dimë si ka ardhur tërë kohën ka bërë fushatë dhe kundër fushatë për ta realizuar një qëllim të cilin tash e ka realizuar. Tash është mirë, është stabilizuar, por nuk ka qenë stabil kur ka qenë në Inkubatorin e Biznesit, sepse ka marrë vërejtje edhe nga drejtori të cilin tash e ka këtu.

Bujar Nevzadi- unë dola për të reagu për një anëtar të Kuvendit i cili po na jep moral vazhdimisht. Unë e kam thënë vazhdimisht se moral nuk mund të na jep dikush që është i pamoralshëm. Nuk lejoj të më shesin moral njerëzit e pamoralshëm. Moral të mban ai që ka moral. Ne e dimë biografinë e secilit në Gjilan dhe nuk ka nevojë të flasin për moral të pamoralshmit.

Fatbardhë Selmani- së pari aty ku flitet për rregulla dhe moralin aty dihet se ka më së paku moral. Sa i përket subvencioneve të cilat i ka marrë familja e ime, unë dhe të gjithë qytetarët, por sidomos ata që punojnë në Komunë e dinë që prindi im ka qenë i sëmurë nga një sëmurje infektive dhe e ka gëzuar një të drejtë për subvencione. Për ato mjete janë dhënë sipas procedurave ligjore e të cilat i kanë takuar prindërit dhe motrës, ndërsa sa i përket subvencionet që i kam marrë unë, kam marrë vetëm bursë edhe atë në sajë të meritës për notën mesatare të cilën e kam pasur. Unë konsideroj se është shumë e turpshme për një anëtar të kuvendit të merret me këso gjëra dhe të përmenden subvencionet shëndetësore të cilat i ka marrë familja e ime. Jam shumë e sigurt se ato subvencione që i kam marrë unë nuk e kanë penguar aspak punën e Hendikosit dhe OJQ-ve të tjera.

Avdyl Aliu- unë nuk bëhem merak shumë për dike që nuk më njeh, por sikur të më kishte thënë dikush diçka që më njeh isha bërë merak. Fundi i fundit thonë se :” qeni i leh ata që nuk i njeh”.

Sahit Abazi- po vazhdon ai avazi i sjelljes me opozitën dhe kjo tregon më së mirë për nivelin e transparencës dhe gjendjes të cilën e kemi këtu. Unë gjatë karrierës sime e kam pasur fatin dy herë të jem kryetar i shkollave të mesme në Gjilan. Dy herë kam qenë anëtarë i kryesisë së degës së PDK-së në Gjilan me një konkurrencë të ashpër, por kam pasur edhe pozicione të tjera, kurse sot jam shef i grupit kuvendar të PDK-së. Unë e thash se z. Arbeni është vetëm një zëdhënës i dobët i kryetarit. Mirëpo ne nuk jemi këtu vetëm për të bërë akuza, por jemi për të bërë zgjidhje dhe për të punuar në dobi të Komunës dhe qytetarëve të saj.

Kërkojmë falje nga z. Sahiti, sepse për shkak të pengesave teknike nuk ka pasur mundësi që të evidentohet tërë fjala e tij për këtë rast (nga sekretaria).

Izmi Zeka- të nderuar anëtarë të Kuvendit edhe Gjilani dhe tërë Kosova është ballafaquar me sfida, por mua më intereson raporti i kryetarit të Komunës dhe raporti është ai për të cilin po flasim. Ne nuk duhet asnjëri të ikim nga raporti, por duhet të raportojmë gjerë e gjatë, sepse ky raport si është i plotë epet njëherë në vit. Pse nuk po diskutojmë për raportin, por po bëhemi në njëfarë mënyre peng i disa procedurave dhe mandej po kemi problem në mbarëvajtje. Unë do të kisha deshtë nga kryetari i Komunës, por nuk do të them atë se çka ka premtuar në të kaluarën, por do t’ i them mos u merr me PDK-në, harroje PDK-në?! Harroje në kuptimin më të mirë, sepse PDK e ka pasur pushtetin e ka mbajtur 6 -7 vite, kurse tash jeni ju! Mirëpo edhe një po e them se ne betimin kur e kemi dhënë kemi thënë se ne do të punojmë për të gjithë qytetarët e Gjilanit dhe jo për partitë politike?

Ju e dini sa punëtorë me kontrata në vepër i keni pranuar? E dini sa projekte janë realizuar nga viti 2013?

A ka ndonjë projekt, tregoni saktë, sepse në raport ka qenë deshtë të figurojë se cilat projekte janë realizuar për vitin 2014? Mirëpo mund ta përmendni edhe dietën, por përmendi edhe borxhet, por kjo nuk iu ndihmon.

Unë e di që në mandatin e kaluar iu kanë ndarë disa mjete dhe ju i keni bërë disa lëvizje dhe i keni bërë disa zgjidhje.

Nuk ka qeveri në botë që nuk ka obligime, nuk mund të punohet ndryshe. Respektoni ligjet, ne jemi për ta respektuar ligjin, por nuk jemi dhe unë personalisht nuk jam për një gjuhë çfarë po flitet këtu? Unë nuk vijë në këtë Kuvend për t’u fyer nga dikush as për ta fyer dike? Ne kërkojmë argumente dhe nëse dikush edhe në mandatin e PDK-së ka shkel ligjin, duhet ta diskutojmë. Ne nuk jemi këtu gjykatë, prandaj duhet dhe do të iu lus merrni me gjëra konkrete. Gjilanasit presin punë dhe nuk iu intereson zhurma që e bëjmë ne me njëri tjetrin dhe sa po magjistrojnë dhe doktorojnë në këtë Kuvend? Gjilanasve i intereson sa po bëhet punë. Kryetari i Komunës nuk mund t’ i obligimit dhe përgjegjësisë ligjore, por edhe mund t’ i bartë. Mirë është bartja e kompetencave dhe e përgjegjësisë i cili deklaroi se kjo nuk është si modeli i PDK-së, mirëpo ligji e ka rregulluar ashtu dhe diçka çka e rregullon ligji, nuk mund as të shpërndahet dhe të dërgohet më poshtë. Përgjegjësia bie mbi kryetarin e Komunës, për të gjitha ato që po ndodhin. Unë jam ithtar i gjërave konkrete. Raportin unë e kam lexuar, por gjërat po duken në qytet. Po thuhet do ta bëjmë, kemi pasur bashkëpunim me

mekanizmat ndërkombëtar dhe OJQ-të. Mirëpo çfarë dobie ka prej atij bashkëpunimi ? Jemi lodhur qe 15 vite duke thënë se kemi bashkëpunim.

Kryetari i Komunës duhet ta lejë nivelin qendror dhe më tepër duhet të merret me gjilanas, sepse po thotë i ka 27 mijë vota. Ata qytetarë e kanë votuar kryetarin për ta ndihmuar Gjilanin dhe jo për t' u marrë me atë se a ka LDK-ja probleme apo jo ? A po bëhen koalicionet apo jo ? Jo kryetari të merret me çështjen e veteranëve, por të merret me gjëra konkrete. Kryetari duhet të merret me gjëra të prekshme si kanalizimi, uji , asfaltimi etj.

Unë do të jem përkrahës i tërë atyre të mirave që i bën kryetari i Komunës, të gjitha ato ndryshime, sepse çdo qeverisje do të bëj ndryshime. Në fund ju lutemi me sinjeritetin më të madh, fyerjet më nuk mund t' i durojmë , sepse Gjilani nuk dëshiron tension. U përmend nga dikush ne 15 vite kemi qenë qyteti i një kulture që rrallë e gjen diku. Kryetari të merret me gjëra konkrete ose më shkurt me punët e shtëpisë. Ju faleminderit dhe respekt për të gjithë anëtarët e Kuvendit.

Lutfi Haziri- atëherë për fund duke dashur që të jap sqarime për aq sa mund të jap sqarime iu falënderoj për angazhim dhe për nënvizim të çështjeve të cilat janë në interes të taujin, grupeve politike dhe qytetarëve të Gjilanit. Jam i i prirur për të dëgjuar, por edhe jam i prirur për të mos lejuar personalizim të raporteve dhe zgjidhje të problemeve për motive personale. Jam predikuar edhe për mosardhje dhe po vazhdoj të predikohem, por unë edhe më tutje konsideroj se KK është organi më i lartë i cili duhet të punojë sipas kalendarit të vetë dhe duhet të vendos sipas kalendarit dhe agjendës së vetë. Prezenca e kryetarit të Komunës është e dëshirueshme, por jo e domosdoshme në çdo seancë dhe shterim të kërkesës, sepse janë përgjegjësitë që e kanë marrë këtë rol dhe këtë detyrë. E kam marrë edhe raportin e OJQ-ve të cilat e mbikëqyrin punën tonë dhe jam munduar t' i lexoj me kujdes dhe pastaj duhet respektuar rekomandimet. Edhe auditorin e brendshëm edhe auditorin e pavarur dhe organet e tjera si KRP-ja që e rregullojnë fushën e prokurimit dhe sektorët e tjerë.

Fjala e anëtarëve të Kuvendit për mua dhe Asamblesë Komunale për mua e ka rëndësinë e veçantë.

Shëndetësia primare edhe më tutje ballafaqohet me sfida, prandaj unë nuk e kam paraqit asnjë angazhim kozmetikë të QKMF-së dhe të Drejtorisë për Shëndetësi. Vazhdojnë problemet e njëjta prej Zhegrës në Stançiq , Pogradë, Verbiçë të Zhegocit. Në të gjitha institucionet ne jemi marrë me renovime dhe në infrastrukturë kemi investuar më shumë, por problemin e stafit jemi duke u përpjekur për ta zgjidhur së bashku me Qeverinë për dallim prej komunave të tjera. Ne mendojmë se këtë problem duhet ta zgjidhim me qeveri, nëse jo atëherë duhet ta bëjmë një zgjidhje alternative të kësaj çështje, sepse stafi aktual nuk ka mundësi për ta mbuluar terrenin.

Sa i përket Hendikosit dhe OJQ-së së Shurdhmemecëve dhe të Verbërve kam nënshkruar marrëveshje për t' i rrit subvencionet, do t' ia bartim mjetet e cila bartje do të ndodh shumë shpejtë. Hendikosi dhe shoqatat që e shfrytëzojnë atë objekt kanë problem me shpenzime të kaluara. Shpenzimet e rrymës të shërbimeve komunale janë enorme të grumbulluara. Duhet edhe atje duhet bërë një servisim i borxheve e cila mund të fillojë vetëm nëse e shlyejmë këstin e tre mujorit të parë sipas KEC-it. Duhet shoqatat ta programojnë borxhin me KEC-in, kurse obligimet duhet t' i merr Komuna për shpenzime në mënyrë që ato mijëra euro si borxhe të rrymës në ato shoqata dhe shërbimet e tjera komunale të fillojmë për t' i paguar. Mirëpo në ato shoqata duhet ndërruar edhe sistemin e ngrohjes me sistem më të lirë, sepse atje ngrohja bëhet me rrymë. Ky është problemi i vetëm që ekziston atje dhe nuk ka shoqata tjera që operojnë atje.

Mirëpo këto shoqata kanë pasur edhe dhurues, por tash ata po largohen dhe këto mbesin barrë e Komunës, por ngjashëm po ndodh edhe me Shoqatën “Liria”, sepse edhe ata kanë shpenzime dhe kanë krijuar mjaft borxhe.

Në fund po theksoj se në faqe 13.14 dhe 15 janë të gjitha projektet e specifikuara të cilat janë vazhdimësi e qeverisjes së kaluar dhe të cilat janë në bashkëpunim me dhuruesit. Ne parimin e kontinuitetit e kemi ruajtur përveç shkurtimeve buxhetore, i cili shkurtim ka ndodhur për shkak të rritjes së pagave. Si vazhdimësi e projekteve i kemi 12 projekte të cilat kanë kosto të madhe si “Kodra e Dëshmorëve” dhe rruga e Kosaqës etj. Ne do t' i vazhdojmë dhe nuk do të mbesin investimet të shkojnë huq pa marrë parasysh se si janë zhvilluar, por janë problemet tjera të cilat po na barten nga sektori në sektorë dhe prej qeverisë në qeveri. A është Qeveria borxhli ndaj Gjilanit, me siguri se është borxhli derisa t' i shlyejmë borxhet.

Faleminderit, por sa i përket zhvillimeve krejt të tjera, unë marrë sinjerisht, por nuk mund ta relativizoj rolin tim dhe angazhimin tim politik, sepse jam kandidat i një partie politike. Secili prej neve kemi një subjekt politik, kemi begrande dhe kemi një të kaluar e cila ka dal para qytetarëve në peshore dhe duhet të merret përgjegjësi secili për atë që i takon. Unë jam që në Kuvend të jetë një gjuhë politike parlamentare duke mos dashur në asnjë mënyrë për ta emituar gjuhën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse ne kemi krijuar një

gjuhë dhe kulturë të nivelit parlamentar dhe duhet ta ruajmë këtë nivel. Kemi filluar të përmendim familje dhe kemi filluar t' i përmendim të bërat dhe të pabërat e cila dukuri nuk është as e mirë as nevojë të personalizohen këto raste.

Secili në Gjilan e dimë kush çka është dhe nuk mund as ta rrisim as ta zvogëlojmë. Respekti i ndërsjellë na ndihmon të punojmë më mirë. Faleminderit për të gjitha ato që i keni thënë, kurse mua më mbetet për t' i realizuar detyrat sipas agjendës dhe ligjit në fuqi.

Bujar Nevzadi- unë nuk jam i interesuar të polemizoj me njerëz të cilët nuk kanë argumente, sepse kur nuk kanë argumente mandej fyejnë. Nuk isha i interesuar të flas me të gjithë kur të dëshirojnë, por edhe unë mendoj ashtu si kryetari se nuk kemi nevojë t' i personalizojmë gjërat. Mirëpo, z. kryetar ju po e dëgjoni shefin e grupit se çfarë pyetje bën këtu! Ky bën vazhdimisht këso fyerje! Unë absolut nuk jam për ta ngritur tensionin, por ky nuk ka argumente, po ju e dini që familja e tij i ka keqpërdorur mjetet e tërmetit, po duhet t' i përmendim. Ka ndërtuar ndërtime pa leje, sot është duke bërë ndërtime pa leje, ky e ka bllokuar kanalizimin në një lagje ku jetojnë 50 familje dhe sa herë bie shi atyre familjeve iu depërton uji në shtëpi. Duhet të merrni masa ju si parti dhe ju si kryetari i Komunës, duhet ta zgjidhni këtë problem. Urdhëro me argumente z. shef i grupit dhe jo me fyerje. Të gjitha çka mund t' i thuash për 25 vite urdhëro, por mos fyej !

Riad Rashiti- së pari kryetar po shihet se kontrolli të ka dalë nga dora në tërësi! Kur në seancën e KK nuk ka kontroll dhe nuk ka debat, por ka fyerje dhe ofendime, kjo po tregon se ju si kryetari i komunës nuk e keni gjendjen në kontroll. Kur një shef i grupit fyen, kur një ministër tash i cili ka qenë anëtar i Kuvendit këtu ka ofenduar me fjalë më të rënda anëtarët e Kuvendit të cilat kanë qenë të detyruara ta lëshojnë seancën.

Kur këto fyerje bëhen para medieve, a mundet të paramendohet se çfarë presioni unë kam pasur dhe kanë qytetarët dhe zyrtarët tjerë të cilët orientohen për të kryer punë në administratë.

Kjo ishte vetëm një para hyrje, sepse unë fjalën nuk e ka marrë asnjëherë, prandaj po lidhem me çështjen e rendit të ditës. Lidhur me borxhet për një vit keni deklaruar në opinion se Komuna e Gjilanit i ka 9 milion borxhe, kurse sot e keni thënë realitetin se Komuna e Gjilanit i ka borxh 4 milion e 112 mijë €. Mirëpo nuk e keni përmendur se i keni gjetur edhe 577 mijë € suficit. Nuk i përmendini obligimet të cilat i ka Qeveria e Kosovës për projektin e Lumit Mirusha e cila e ka për obligim për të krijuar obligime për mallra dhe shërbime, por janë krijuar obligime për shpronësime të projektit më të madh që ka qenë Lumi Mirusha.

Është mirë që më në fund e pranuat realitetin e obligimeve, por nuk është mirë që gjatë tërë mandatit të juaj dështimet e qeverisjes së juaj t' i arsyetoni se gjëja keni pasur borxhe. U përmenden investimet e jashtme, por duhet ta dini se zyrtarët e komunës duhet të dihet se çfarë sjellje kanë ndaj investitorëve të huaj. U përmend projekti i fizibilitetit për dy projekte. Është mirë kryetar ta thoni të vërtetën, sepse nuk është mirë që të thoni se ne jemi duke e kryer studimin e fizibilitetit, për transportin publik, kur ne e kemi kryer atë dhe e kemi të gatshëm.

Projekti i shkollave të mesme sipas PPP, 2.5 vite është punuar, personalisht kam punuar në atë projekt, kurse ju thoni se ne jemi duke punuar në atë projekt? Po ashtu për zonën ekonomike kemi marrë donacion dhe kanë qenë përfaqësues të ambasadave Çeke, sepse ekspertët e Çekisë e kanë financuar dhe hartuar projektin dhe kanë dhënë arsyetim se ajo zonë është e dobishme për Komunën e Gjilanit.

E përmendet decentralizimi e pushteti, por nuk është decentralizim shuarja e DKRS-së dhe centralizmi në Zyrën e Kryetarit të Komunës. Po ashtu inspeksioni është centralizim. Realizmi i të hyrave vetanake është për 600 mijë euro më pak se sa planifikimi dhe jo ashtu si e thoni ju ! Te taksat komunale i kemi 100 mijë euro më pak, kurse te Zhvillimi Ekonomik 100 mijë euro. Mirëpo kanë ardhur edhe 860 mijë euro nga gjobat në trafik e të cilat janë të hyra indirekte dhe jo nga efikasiteti i punës së drejtorive komunale.

Në vijim të fjalës së tij z. Rashiti pati edhe disa vërejtje përkitazi me taksat komunale, por vërejtje kryesore ishte se qytetarëve iu kanë kthyer shumica e taksave të cilat më parë i kishte hequr qeverisja e PDK-së.

OSHP-ja vazhdimisht po anulon tenderë që po i shpall Komuna, nga 109 aktivitete të prokurimit, 79 prej tyre janë kryer pa procedurë të hapur, kurse vetëm 30 janë shpallur me procedurë të hapur. Pse Prokuroria Themelore në Gjilan po i hesht 4 lëndë të cilat ne i kemi dërguar? Unë e di, por po pyes a din pse po i hesht ? A ka ndonjë ndikim nga ana e juaj direkt apo indirekte ? Sa i përket ndërtimeve pa leje pse nuk është marrë asnjë veprim për rrënim edhe pse ka qenë kompania e kontraktuar?

Po thoni se keni bërë kursime të buxhetit, por kjo qëndron vetëm për sa i përket drekave zyrtare nga ana kryetarit, por nuk është ai shpenzim prej 4 mijë euro që e thoni ju, sepse në administratë në tërësi ka shpenzime shumë më të mëdha. Sa i përket buxhetit asnjë euro nuk është rritur buxheti i Gjilanit, por

përkundrazi Gjilanit iu janë ndarë për investime kapitale vetëm 1.2 milion euro, sa iu janë ndarë Komunës së Leposaviqit.

Keni thënë kryetar se këtë vit do të fillojë rruga, Gjilan –Bujanoc, por kjo është deklarata e papërgjegjshme, sepse për këtë projekt nuk janë ndarë mjete. Keni thënë se Gjilanit i kanë ikur dhuruesit, por ta thoni më saktë cilët dhurues i kanë ikur Gjilanit?

Në fund do të kisha pasur dëshirë për ta ditur se nga ato vizita të shumta që i keni pasur jashtë shtetit të na informoni se çfarë të mira i keni sjell Gjilanit?

Lutfi Haziri-së pari zgjidhja e problemeve e ka pasur ndikimin e vetë, por unë nuk kam prit që do të dalin dhe të thonë faleminderit që po e trajton buxhetin në këtë mënyrë, përveç që e falënderoj edhe njëherë grupin e LVV si opozitë. Unë shpenzime nuk kam bërë, por nëse vartësit e mi kanë bërë shpenzime, unë jam për t' i parë ato shpenzime dhe këtë vit kam vendosur për ta shtrënguar edhe më tutje çështjen e shpenzimeve.

Nëse nuk mund ta lexoni buxhetin drejtë dhe nuk mund t' i gjeni përmirësimet në buxhet është çështje tjetër, por unë po iu siguroj se buxheti i votuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në krahasim me vitin e kaluar është përmirësuar dukshëm në tri kategori: në kategorinë e investimeve kapitale, subvencioneve në bujqësi dhe borxheve kontingjente (shpronësimeve). Unë, po i siguroj që traseje e rrugës, Prishtinë-Gjilan- Dheu i Bardhë është duke u punuar, studimi paralelisht është duke u bërë dhe mobilizimi i mjeteve financiare është duke u bërë. Punën e kaluar në Gjilan e thamë që të mos përmendet, por u përmend rasti i tërmetit, por hetuesia në Gjilan ka folur dhe ai rast është mbyll. Sa i përket pyetjet që u bën në fund, ato nuk janë të qëndrueshme dhe unë nuk ndërhyjë as në organe të Kuvendit dhe nuk e kam ndërmend ta kontrolloj Kuvendin, sepse nuk kam kulturë kontrolli, situata është në duar të juaja. Në Zyrën time situata është në përgjegjësinë time.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 3.1 e rendit të punës

Aprovohet pika 3.1 e rendit të punës: Raporti i kryetarit të Komunës për vitin 2014, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, 7 ishin kundër, kurse të tjerat abstenime.

Pas kësaj pike të rendit të punës, kryesuesja në ora 13.45 min i liron anëtarët e Kuvendit deri në ora 15.00

3.2 Raporti financiar Janar-Dhjetor 2014

Zijadin Maliqi-- Raporti financiar është i përgatitur në mënyrën më të mirë të mundshme, është gjithëpërfshirës duke filluar nga planifikimi i buxheti fillestar deri tek ai përfundimtar, pastaj te të hyrat sipas kategorive të caktuara etj. Unë nuk po e komentoj më detajisht, sepse ne sot mund ta rekomandojmë për aprovim në Kuvend, kurse në Kuvend do të bisedojmë më tepër.

Jemi të kënaqur edhe më të hyrat, sepse kemi të hyra më të mëdha, në krahasim me vitin paraprak diku afër 12.5%, kurse në krahasim me të planifikuarën e kemi një ngecje 2%.

Te shpenzimet shihet se është bërë një menaxhim i mirë i buxhetit nëpër kategori të caktuara, kemi reduktime të shpenzimeve, aty ku ka pasur mundësi me qëllim që një pjesë e borxheve të mbetura nga vitet paraprake të shlyhen, por përsëri mbetet një shumë mjaft e mirë e borxheve për pa u paguar, por shihet se i kemi shlyer mbi 2 milion € borxhe nga vitit 2013 dhe më herët.

Nga kjo shihet se është një menaxhim i mirë i buxhetit, por më detalisht do të bisedojmë në seancë të Kuvendit, prandaj unë jam që të aprovohet ky raport financiar kështu si është sjell në seancën e Kuvendit.

Nevzad Isufi- Duke qenë se raportimet financiare ndërmjet 9 mujorit dhe këtij 12 mujori janë shumë afër, më duket se në njërin nga raportet ka një gabim. Që në fillim te faqja e parë, te burimi i financimit përfundimtar, rreshti i dytë, te të hyrat vetanake të vitit 2013, kemi shumën 3780.000,00, të njëjtën shumë e kemi pasur edhe te raporti 9 mujor, vetëm se aty thuhet të hyrat vetanake të vitit 2014. Po në të njëjtin vend në radhën në vazhdim, te të hyrat vetanake të bartura, në raportin e tashëm e kemi vitin 2012 dhe shumën 377.062,83€, ndërsa te nëntë mujori e kemi të njëjtën shumë, vetëm se aty kemi vitin 2013. Cilës duhet besuar dhe cila është saktë e cilat është gabim? Si është e mundur që të mbesin plotësisht shuma për bartje të njëjtat madje edhe me cent, nga viti në vit, pra për 2012, 2013 dhe 2014?!

Te faqja 3, te kategoria mallra dhe shërbime, në tremujorin e fundit kemi shpenzime me të mëdha se te 9 mujori, kështu e kemi te QKMF-ja për 9 muaj 175.483.97€ ndërsa vetëm në tremujorin e fundit kemi 284.625,12€.d.m.th afër 110 mijë € më shumë. Kështu është edhe te urbanizmi te kadastri, te zhvillimi ekonomik, në arsim, por edhe në resorët tjerë. Pra nuk është fjala për shpenzime kapitale, por për mallra dhe shërbime. Pse ndodhë kjo?, a janë këto shenja të planifikimit të keq e stihik apo janë shpenzuar vetëm sa për të harxhuar parat?

Riad Rashiti- unë në emër të grupit të PDK-së do t' i paraqes vërejtjet tona në raportin e vitit 2014. Dëshiroj që të jetë ashtu si po thuhet nga pozita që ky raport të jetë i paraqitur mirë dhe detajisht, por ne e vlerësojmë të kundërtën, sepse tri periudhat e tjera paraprake si tre mujori i tretë dhe në secilin raport është paraqitur edhe krahasimi i shpenzimeve të vitit aktual me shpenzimet e këtij viti. Mirëpo në këtë raport të vitit 2014 kjo e dhënë mungon plotësisht. Arsytet pse nuk është bërë ky krahasim është mirë t' i thotë drejtori. Përveç kësaj mungojnë edhe informacionet e tjera të cilat janë paraqitur në raport edhe pse quhet analitik. Ne kemi qindra mijëra euro subvencione të ndara nga vitit i kaluar, janë diku mbi 300-400 mijë €, por janë të dhënat vetëm për drejtori dhe jo për cilat raste janë dhënë këto subvencione me çfarë vendimi dhe kur janë dhënë? Ne me muaj të tërë i kemi kërkuar këto informacione, por kërkesa e jonë është refuzuar, por disa kam arritur për t' i marrë, por jo të gjitha.

Te këto kategori për subvencione kemi vërejtur se diçka nuk është në rregull dhe është mirë të na jep sqarime u.d së drejtorit të Financave. Nuk e kemi të qartë pse brenda 5 ditëve në OJQ, t'i epen dy subvencione, sepse me 31 janar iu janë ndarë 1 mijë 800 €, trupës muzikore, por brenda javës pas 5 ditëve më 5 shkurt iu janë ndarë përsëri 1 mijë e 800 €. A është bërë kjo për t' i ikur subvencionit dhe të drejtës që ky subvencion të epet pa vendim dhe aprovimin e KK-së? Mirëpo ajo edhe më e keqja prapë të njëjtës trup muzikore iu janë ndarë edhe 1 mijë e 500 €. Në këtë listë të cilën ne e posedojmë figurojnë subvencione pa kurrfarë emërtimi dhe nuk figuron asnjë emër as i shoqatës, as i individit.

Është rasti konkret "Qendra Rinore" 950 €, por pa emër, mandej subvencione iu janë ndarë një kompanie private po ashtu për organizim të koncerteve dhe atë 1 mijë e 800 € njëherë dhe përsëri edhe 1 mijë e 800 €. Ne nuk jemi kundër ndarjes së subvencioneve, por shtrohet pyetja, pse dikush i merr nga 4-5 mijë €, kurse dikush nuk mund të merr fare? Sot nuk do të flas më tepër, sepse ka shumë të dhëna jo profesionale dhe ligjore dhe dikush duhet të jep llogari!

Sa i përket shpenzimeve vërehet se te prokurimi ka shumë shkelje procedurale e të cilat vërejtje i kemi paraqitur shumë herë në seancat e KK-së dhe kemi kërkuar informacione, por ato nuk na jepen. Janë dhënë dy kontrata përmes kuotimit në vlerë të njëjtë edhe të njëjtës kompani dhe në të njëjtin muaj. E di që është bërë renovimi i disa zyrave, por nuk e kemi të qartë pse nuk është bërë renovimi me kompaninë e cila ka qenë e kontraktuar për t' i bërë këto renovime. Për zyrën e kryesueses janë shpenzuar 9 mijë e 600 €, por po ashtu ka ndodhur edhe me zyrën e kryetarit. Po e potencoj se ka shumë shpenzime të cilat janë bërë me parregullsi dhe shkelje procedurale.

Sa i përket të hyrave ka rritje, pajtohem, por shtrohet pyeta nga kanë ardhur këto rritje? Të hyrat trefish, apo 200% kanë qenë dhe më të mëdha se planifikimi vetëm te gjobat në trafik dhe gjobat e gjykatave. Në këto dy kategori kanë qenë 350 mijë € të planifikuara, kurse janë inkasuar 850 mijë €. Ko është ajo që ia ka mbuluar juve papunësinë apo efikasitetin në institucionet apo drejtoritë përkatëse e të cilat nuk kanë realizuar planifikimin që ka qenë për vitin 2014.

Në vijim të fjalës së tij z. Rashiti dhe edhe shumë argumente të tjera në kategori të posaçme në të cilat nuk janë realizuar të hyrat e parapara, siç është rasti te qiratë e sidomos te lejet ndërtimore, arsimi, zhvillimi ekonomik, bujqësia etj. Nga papërgjegjësia Komuna e Gjilanit ka inkasuar mjete më pak për 600 e 6 mijë € më pak sipas planifikimit të buxhetit të viti 2014.

Ne mund të bëjmë gara se janë rrit ose zvogëluar shpenzimet, por shpenzimet janë zvogëluar vetëm në 4-5 kategori e të cilat të dhëna z. Rashiti i numëron me radhë.

Shukrie Rapuca- në faqen tre të Raportit financiar thuhet se Drejtoria e Bujqësisë i ka shpenzuar për subvencione mbi 183 mijë €, kurse për investime kapitale mbi 67 mijë €. Mirëpo në tabelën e njëjtë faqe 12 shihet se Drejtoria e Bujqësisë në planifikimin përfundimtar për vitin 2014 ka pasur mbi 202 mijë € për subvencione dhe mbi 54 mijë € për investime kapitale. Kam pyetje pse nuk është shfrytëzuar edhe shuma prej 48 mijë € që ishin të parapara për subvencione dhe 16 mijë € 962 € të cilat ishin të parapara për investime kapitale? Dihet se nevoja për të dy aspektet janë shumë, shumë të mëdha.

Dëshiroj që të më epet përgjigje dikush, sepse drejtori i Bujqësisë nuk qenka prezent, sepse janë mbi 600 e 60 mijë € të pashfrytëzuara.?

Mevlyde Zejnullahu- fillimisht po theksoj se ne si AAK e përkrahim këtë raport financiar të vitit 2014, sepse është një raport mjaft i detajuar nëpër të gjitha segmentet e nevojshme. Shihet fakti se shifra për grumbullimin e të hyrave vetanake që kanë mbetur pa u shfrytëzuar në vlerë prej 840 mijë €, por në bazë të tabelës që janë detajuar këto të hyra që kanë për t' u dedikuar në vitin 2015, shpresojmë se do të ndahen nëpër ato vende të posaçme aty ku është më e nevojshme.

Sa i përket drejtorive në krahasim me buxhetin e vitit 2013 kam vërejt se ka pasur nëpër të gjitha drejtoritë zvogëlim të shpenzimeve, me përjashtim të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik e cila ka harxhuar një buxhet më të madh dhe ky buxhet kryesisht është shpenzuar për investime kapitale e i cili shpenzim do të ndikojë në zhvillim më efikas të qytetit.

Realizmi i të hyrave këtë vit ka qenë më i kënaqshëm në përgjithësi në vlerë prej mbi 97%. Po theksoj se ne e përkrahim dhe kërkojmë që të aprovet ky raport financiar.

Bujar Nevzadi – unë përshëndeti punën e mirë të drejtorit të Financave, sepse vullneti i tij është mjaft i mirë për punë të mbara dhe të mira. Mirëpo i kam disa pyetje: së pari sa është rekapitullimi i shpenzimeve sipas kodeve ekonomike? Sa obligime të vitit 2014 janë paguar dhe edhe sa janë të papaguara? Kujt iu janë paguar dhe kujt i kemi mbetur borxh? Këto informata i kërkoj, sepse sipas neve konsiderojmë se janë bërë pagesa selektive. Pse në raport nuk është paraqitur rekapitullimi i reprezentacionit, i naftës dhe mëditjeve?

Bujar Haziri- sa i përket dy subvencioneve që janë dhënë për DKRS e kam këtë sqarim: Rregullorja për subvencione i lejon kryetarit që të jep subvencione në vlerë prej 2 mijë € për subjekte juridike, kurse për persona fizik deri në 1 mijë € 200 €. Në këtë rast është fjala për subvencionimin e dy kategorive gjatë Flakës së Janarit të viti 2014. Shuma prej 1 mijë 800 € iu ka dedikuar orkestrës e cila ka përforcuar llajf, kurse e dyta është bërë për transferin e çmimeve në kuadër të Flakës së Janarit.

Fehmi Sylejmnai- unë jam i kënaqur me punën e drejtorit të Financave, sepse asnjëherë nuk kemi pasur raport më të detajuar, por unë e kam një pyetje për këtë drejtor. Në disa kolona po e shoh se shkruan mëditje për udhëtime zyrtare brenda vendit është 306 €, mandej kemi shpenzime jashtë vendit 26 mijë € 200 €, akomodim dhe vendosje jashtë vendit 10 mijë € 576 €, shpenzime tjera udhëtime zyrtare jashtë vendit 2 mijë € 746 €. Nëse ka mundësi të na i sqaroni këto kode.

Arben Mehmeti- është mirë që kemi arrit në një situatë ku po shihet se nuk ka asnjë dilemë sa i përket menaxhimit të financave. Është mirë që opozita e lavdëron jashtëzakonisht shumë drejtorin e financave dhe kjo është risi në këtë qeverisje. Kjo është rezultat i qeverisjes së koalicionit aktual. Unë propozoj që opozita të komunikojë me drejtorin aktual, sepse e kanë besimin e plotë dhe po shihet që drejtori po e kryen punën shumë mirë dhe të gjitha debatet që i bëjnë deri më tash më duket se janë të paqëndrueshme.

Ilmi Limani- sa i përket pyetjes së z. Nevzad Isufi, kërkoj falje, sepse është bërë një gabim teknik, sepse raporti është hartuar diku me 25 mars dhe nuk kemi pasur mundësi t' i kontrollojmë disa gjëra, prandaj duhet të jetë viti 2013 dhe 2014.

Sa i përket shpenzimeve në fund të vitit kemi paguar mbi 1 milion e 3 mijë €, borxhe të trashëguara dhe ato janë shpenzime. Mandej ekonomistët e dinë se me 9 nëntor të vitit mbyllen disa Financa dhe nuk ka mundësi të bëhet zotim i mjeteve për investime kapitale, më 26 nëntor për mallra dhe shërbime, me 12 dhjetor për komunalit dhe subvencione. Në këtë formë bartja e mjeteve bëhet vit për vit, sepse kështu e ka përcaktuar ligji. Në vijim të fjalës së tij z. Limani dhe sqarime lidhur me kodet buxhetore nëpër shkolla, por duhet theksuar se kjo varet shumë prej zyrtarëve Financiar se sa ata i kanë ditur gjërat dhe si i kanë regjistruar shpenzimet dhe të hyrat.

Sa i përket mobilet është e vërtetë se janë shpenzuar 39 mijë €, por 26 mijë i kemi paguar borxhe. Këto gjëra dot ' i keni me numër të faturës dhe të gjitha të dhënat e tjera. Të gjitha borxhet të cilat janë paguar janë 2 milion e 598 mijë €. Te bujqësia është e vërtetë, por të hyra të nëntorit dhe dhjetorit e që nuk kemi pasur mundësi të bëjmë shpenzime.

Sadullah Kadriu- unë e kam një vërejtje, sepse për Flakën e janarit u patëm marrë vesh që një dramë apo një koncert të mbahet në Komunën e Bujanocit, por për 300 €, kjo marrëveshje nuk është realizuar, edhe pse ne i kishim kontaktuar përfaqësuesit e Komunës së Bujanocit. Nuk është realizuar një ide aq e rëndësishme për 300 €. Po të kisha qenë në gjendje më të mirë financiare, personalisht me para të mia do ta kisha përmbushur këtë premtim.

Riad Rashiti- ne dhamë lëvdata për punën e mirë të drejtorit në aspektin teknik se si është bërë raporti, por nuk dhamë vlerësim pozitiv sa i përket përmbajtjes së raportit ! Për këtë arsyeje unë kërkoj që të mos keqpërdoret fjala dhe vlerësimi që dhamë ne për një çështje tjetër.

Sa i përket drejtorit të Kulturës po i them se i keni pasur 4 vendime në vlerë prej 1 mijë e 500 € dhe kjo është bërë brenda javës. Të gjitha procedurat për financim të Flakës ka qenë deshtë të vijnë në Kuvend dhe ka qenë deshtë të dihet kostoja në Kuvend. Ka qenë obligim që të bëhet raport financiar vetëm për Flakën e Janarit, sepse kemi dhënë raport të tillë për këtë manifestim. Këtë vit nuk është ofruar raport financiar, prandaj është mirë të na sillni raport të veçantë për shpenzime të Flakës së Janarit.

Drejtori i Financave vazhdimisht thotë do t' i keni, do t' i bëjmë, por ne po flasim për raportin vjetor 2014 dhe kur diskutohet raporti vjetor ai duhet të vijë i përfunduar.

Ju në përgjithësi në kode keni shpenzuar mjete për mobile dhe në total del se Komuna ka shpenzuar mbi 122 mijë € vetëm për mobile, kurse më 2013 kanë qenë 44 mijë €. Është trefishuar ky shpenzim, prandaj është mirë të na sqaroni pse ka ndodhur kjo? Ju gjatë vitit i keni shpenzuar mbi 44 mijë € vetëm për kompjuterë, kurse në qeverisjen tonë nuk ka pasur zyrë pa kompjuter. Shtrohet pyetje pse u bënë këto shpenzime? Makina fotokopjuese 15 mijë e 190 €, pajisje tjera pa emër janë shpenzuar në total 116 mijë € dhe nuk dihet se çka janë këto pajisje tjera. Unë nuk po lëshohem në detale, por është mirë të na jepni sqarime dhe ne me shkrim qysh moti i kemi kërkuar këto përgjigje, por ju nuk keni kthyer, prandaj për këtë po i bëj në Kuvend.

Fehmi Sylejmani- më duket se u keqkuptuam te vlerësimi i raportit, sepse ne e thamë se ky është një raport përmbledhës për dallim nga raporti i kryetarit, sepse në aspektin teknik ky financiar është shumë më në nivel se raporti i kryetarit. Në aspektin profesional le të flasim profesionistët, por në pyetjen time drejtori harroi të përgjigjet, prandaj kërkoj që të më jep përgjigje?

Ilmi Limani-akomodimi dhe udhëtimi zyrtar brenda vendit ishte një pyetje? Vazhdimisht po bëhen gabime nga zyrtarët në ribalans, prandaj ne nuk mund më t' i korrigjojmë.

Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit janë 22 mijë e 423 €, kemi paguar borxhe të Kompanisë "Merkatori", sepse e kanë bërë transportin e klubeve të ndryshme në vitin 2013 e më herët

Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit 103 mijë €, kemi larë borxhe e të cilat kryesisht janë të Merkatorit. Unë këto gjëra i kam të shkruara afër 70 faqe dhe kam mundësi në mënyrë elektronike t' i sqaroj para juve.

Ibish Ibishi- si po e vërej unë këtu po kërkohet sqarim nga opozita për të gjitha shpenzimet duke i përfshirë edhe ato të cilat janë paguar si borxhe. Unë propozoj që këto borxhe të paraqiten një nga një edhe nëse janë 100 faqe. Të sqarohet kjo punë njëherë e përgjithmonë dhe mos të kemi dilema se a janë paguar apo do të paguhen? Ne që nga ora 10 deri ora 13 u lodhëm duke thënë borxhe dhe pjesa dërmuese e opozitës e ka përmend punën e borxheve. Të paraqiten këto borxhe një nga një dhe më tepër mos të kemi dilemë edhe më tutje?

Zijadin Maliqi- qysh në fillim e thash se raporti është i përgatitur mirë dhe gjithëpërfshirës dhe qëndroj pas sajë. Unë i kam parë raportet e shumë komunave tjera në të cilat me tri faqe epet raporti dhe në atë mënyrë aprovohet. Nëse drejtori do t' i kishte paraqitur shpenzim për shpenzim nga 2 e tri euro, do të ishte bërë një material të cilin vështirë do ta kishim sjell në sallë. Ajo nuk ka mundësi të bëhet, por ka mundësi të bëhet në mënyrë elektronike dhe së paku t' i dërgohet shefave të grupeve. Unë mendoj se me buxhet është punuar mirë dhe kategoria më e ndjeshme në buxhet janë mallrat dhe shërbimet dhe këtu është tërë problematika. Te mallrat dhe shërbimet borxhe janë paguar mbi 1 milion e 3 mijë €. Krahësuar me vitin 2013 për mallra dhe shërbime janë harxhuar për 1 milion e 240 mijë € më pak në vitin 2014 se sa në vitin 2013.

Gjithsej borxhe të paguara të vitit 2013 e më herët janë 2 milion e 598 mijë €.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 3.2 e rendit të punës ?

Aprovohet pika 3.2 e rendit të punës: raporti Financiar për vitin 2014, me 24 vota të anëtarëve të Kuvendit, 4 ishin kundër, kurse të tjerat ishin abstenime.

3.3 Propozim vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2013 dhe 2014, në vitin fiskal 2015

Zijadin Maliqi-pika 3.2 dhe 3.3 janë të ngjashme, prandaj propozoj që të dy këto pikë të rendit të punës të debatohen me një pikë.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- z. Zijadin Maliqi propozoi që pika 3.3 dhe 3.4 të debatohen me një pikë, sepse të dy pikët kanë të bëjnë me transfer të mjeteve. Kush është për këtë propozim?

Aprovohet propozimi i z. Z. Maliqi që pika 3.3 dhe 3.4 të debatohen si një pikë e vetme me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

Zijadin Maliqi-është një praktikë që një pjesë e mjeteve mbesin për pa u shpenzuar gjatë vitit buxhetor dhe kjo ndodh sidomos në muajin nëntor dhe dhjetor. Në pjesën e parë janë afër 200 mijë euro për projekte kapitale, kurse pjesa tjetër për dy muajt e fundit nëntor dhe dhjetor e të cilat duhet të ridestinohen.

Tjetra është te arsimi te pagat e punëtorëve dhe janë në pyetje 88 mijë €, sepse te shkollat mesme kemi tepërcë, kurse te shkollat fillore dhe kategoritë e tjera kemi mungesë.

Riad Rashiti- e përkrahim këtë transfer të mjeteve, por kërkojmë që edhe shuma të caktohet në vendim për transfer të këtyre mjeteve.

Fehmi Sylejmani – edhe ne e përkrahim këtë transfer, por a hyjnë në këtë transfer edhe tre punëtorët e Stadiumit të qytetit, nëse jo të na epni sqarime?

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- këto mjete janë për transfer në arsim dhe nuk kanë të bëjnë me Stadiumin e qytetit.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 3.3 dhe 3.4

Aprovohet pika 3.3 dhe 3.4: 3.3 Propozim vendimi për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2013 dhe 2014, në vitin fiskal 2015 - 3.4 Propozim vendimi për lejimin e transferit dhe harmonizimit të mjeteve financiare, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit (33).

3.5 Propozim vendimi për miratimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit dhe Komiteteve të KK-ës për vitin 2015

Nuk pati debatues për këtë pikë të rendit të punës, kurse kryesuesja kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të aprovohet, pika 3.5 e rendit të punës ?

Aprovohet pika 3.5 e rendit të punës: Propozim vendimi për miratimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit dhe Komiteteve të KK-ës për vitin 2015, me 32 vota të anëtarëve të Kuvendit.

3.6 Propozim vendimi për anulimin e pjesshëm të vendimit 01.nr.7840 të datës 14.07.2009 dhe vendimit 01.nr.16-7086 të datës 30.05.2011

Nevzad Rushiti- Komiteti për Pronë e ka mbajtur takimin më 11.2.2015 dhe ka shqyrtuar një kërkesë të kolegut tonë, Nevzad Isufi për një pronë në Zonën kadastrale të Gjilanit, pjese tek FSK-ja. Ne si komitet jemi marrë vesh që pjesërisht të anulohet ky vendim ose dy vendime të vitit 2009 dhe 2010. Komuna e Gjilanit nuk ka pasur mundësi ta shpronësoj, kurse kjo pronë ka mbetur peng për disa vite, prandaj ne i kemi rekomanduar Kuvendit që pjesërisht të anulohet ai vendim, në mënyrë që kolegu i ynë ta gëzojë të drejtën e pasurisë së vetë. Ajo pasuri është blerë nga AKP (AKM), dokumentacioni është komplet, mendoj se duhet aprovuar këtë propozim.

Arben Mehmeti- kjo është një kërkesë që vjen nga shefi i Sektorit të Pronës, por është edhe një parcelë 10 mijë e 719m² me numër të parcelave 13500, mirëpo me kërkesë të palës kjo parcelë dhe me këtë sipërfaqe nuk figuron askund? Kjo është pyetje edhe për kryetarin e Komitetit dhe për drejtorin për të na dhënë sqarime. Kërkesa e palës në të cilën janë dhënë të dhënat, kur ta llogarisim del një shifër ndryshe nga ajo që është e llogaritur në dokumentin zyrtar të AKP-së të cilin e kemi këtu. Në këtë Kuvend duhet të na jep sqarime drejtori i Kadastrit dhe kryetari i Komitetit përkatës.

Shukrie Rapuca- sot nga ne po kërkohet të miratohet një vendim që ne t' i mundësojmë AKP-së faljen e sipërfaqe së tokës prej 18.6 hektar të cilën ky Kuvend në vitin 2009 ai ka dhënë Shkollës së Bujqësisë për nevojat e sajë profesionale. Pra kërkesa e AKP-së në fjalë edhe pse e ka dhënë për këtë qëllim, ata për interesat e tyre për pa u konsultuar fare me Komunën e ka shit- blerë këtë tokë për vetëm 79 mijë €.

Do të thotë 6 hektarë tokë për 79 mijë €. Nuk ka se si mos të shtrohet pyetja pse AKP dhe blerësi nuk kanë shtruar kërkesë para se ta bëjnë shit-blerjen, por tani kur ka përfunduar shit- blerja? Është i rëndësishëm informacioni se Shkolla e Bujqësisë i ka humbur rreth 2 milion €, donacion nga "DANIDA", për shkak të pengesave që AKP i ka bërë duke pamundësuar bartjen e asaj prone, e që më vonë më 2014, ia ka fal një personi fizik. Arsytet pse është veprua kështu vetëm ata i dinë!?

Unë kërkoj që ky propozim-vendim të mos kalojë, sepse ndryshimet e fundit që janë bërë në Ligjin e AKP-së i mundësojnë Komunave që pronat me interes për publikun t' i tërheq nga AKP për nevojat e veta. Kjo tokë gjithsesi i takon Shkollës së Mesme të Bujqësisë, sepse aty do të mund të zhvilloheshin aktivitete të ndryshme profesionale. Po e shfrytëzoj rastin dhe të them se a ka koment kur në kushte të sotme të zhvillimit ekonomik është në rrezik të shuhet për shkak se po i falet toka e Shkollës Bujqësore nga AKP-ja, por duke ndihmuar edhe Komuna.

Sadudin Berisha- një gjë duhet të jetë e qartë, sepse këto nuk janë vendime të kësaj përbërje, por këto janë vendime të përbërjes së mëparshme të KK. Ky vendim i mëparshëm është kontestuar në mënyrën se si janë shpallur zona me interes të qytetarëve të Gjilanit. Ne si KK e kemi sjell një vendim më 18 korrik 2009 për shpalljen e disa parcelave kadastrale me interes të veçantë. Në vazhdim të fjalës së tij z. Berisha dhe sqarime detale lidhur me këtë rast.

Arben Mehmeti- unë mendoj se ka disproporcion në mes të propozimit që vjen nga zyrtari i Drejtorisë, mandej është në disproporcion me kërkesën e palës dhe ky dokumentacion sipas me je nuk është i kompletuar dhe nuk është e qartë për neve. Mendoj se ne si Kuvend, nuk duhet të marrim vendime me dokumente të cilat nuk janë në përputhshmëri me njëra tjetrën. Sipas drejtorit, ky vendim nuk ka asnjë fuqi dhe nuk e kam të qartë pse ne po e marrim këtë vendim për ta procesuar? Unë mendoj se kjo pikë duhet të shtyhet për një seancë tjetër dhe të diskutohet më përmbajtësisht.

Riad Rashiti- unë mendoj se ky vendim është i qartë në qëllim dhe përmbajtje, por nuk e kam të qartë, pse drejtori i Kadastrit e megjulloi tërë këtë situatë duke u kthyer prapa në vendimet të cilat janë marrë në këtë drejtim. Mendoj se nuk është mirë të megjulohet nëse çdo gjë është e qartë! Ne si Komunë nëse e marrim realisht nuk kemi të drejtë të merremi me çështje të pronës të cilat i menaxhon AKP-ja.

Ne një vendim që e kemi më herët ka qenë shumë i qartë dhe është thënë që të pengohet privatizimi i pronave publike komunale të cilat janë në interes të Komunës, sikur që ka qenë rasti të Çerdhja e Fabrikës së ish Integjit. Mirëpo edhe atë vendim ju e keni shfuqizuar dhe pse e keni bërë këtë ju e dini?

Unë po theksoj se nuk është mirë të megjulohen gjërat, por jepni sqarime a duhet të kalojë apo jo!

Bajram Hasani- drejtori i dha disa sqarime, por nuk ishim të gjendje ta kuptojmë në tërësi. Mirëpo unë e kam një pyetje të drejtpërdrejtë: “A është në interes të qytetarëve për t’i shfuqizuar ky vendim apo jo”? Mandej sipas vërejtjeve të Arben Mehmetit, duhet shikuar se ka gabime në numër të parcelave, sepse gabimet në parcela mund të kenë pasoja të mëvonshme.

Sadudin Berisha- shpjegimet ishin të nevojshme, sepse ne po merremi me pasoja! Mandej me ndërmarrjet shoqërore menaxhon dhe qeverisë jo një subjekt i huaj ndërkombëtar dhe për t’u ballafaquar me atë vendim, por menaxhon AKP-ja, me të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat e duhura.

Ligji mbi privatizimin i ka dhënë dhe sot i jep mundësi qeverive komunale që mbi bazën e planeve zhvillimore të territorit të Komunës të identifikojë pronat shoqërore të cilat preken në interes publik. T’i identifikojë, t’i adresoj me projekte realizuese dhe plane rregullative. Në momentin e vlerësimit se është interes publik i qytetarëve të Komunës së Gjilanit tërhiqet nga shitja dhe kalon me automatizëm si pronë komunale. Këtu nuk ka ndodhur ajo dhe është e pandershme të thuhet nga z. Riadi se nuk kemi nevojë të na thuhet ajo. Unë po e shpjegoj se këto gjëra kanë ndodhur në përbërjen e shkuar.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 3.6 e rendit të punës

Aprovohet pika 3.6 e rendit të punës: Propozim vendimi për anulimin e pjesshëm të vendimit 01.nr.7840 të datës 14.07.2009 dhe vendimit 01.nr.16-7086 të datës 30.05.2011, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, 2 ishin kundër, kurse të tjerat abstenime.

Nevzad Isufi- në rastin e pikës së rendit të punës 3.6, fjala është për destinimin që ka qenë për arsim, por ai destinim është marrë dhe është vendos diku tjetër dhe ajo ka mbetur vetëm si peng e që nuk është shfrytëzuar. Nuk janë humbur 2 milion euro, por shkonte e ka marrë sipërfaqen që e ka blerë “Danida” është shfrytëzuar si ka qenë e paraparë. Ka qenë deshtë Drejtoria e Arsimit momentin që iu ka ndarë prona të tërhiqet, sepse i ka

penguar pronarët. AKM është menaxhues i tyre, prandaj nuk kam pasur nevojë të konsultohem, por të kishte pasur nevojë do të isha konsultuar me AKP-në dhe Drejtorinë e Arsimit. Prona në fjalë ka qenë deshtë të bartet për 2-3 javë ose katër, kurse ne kemi pritur mbi një vit për një neglizhencë dhe unë nuk e kam thënë asnjë fjalë, por këto që thuhet se ajo është pronë e shkollës është krejt e pasaktë. Shkolla e ka realizuar qëllimin e vetë diku në tjetër vend, prandaj shkelja është bërë nga Drejtoria e Arsimit. Këtu nuk ka asnjë paqartësi, por vetëm është mjugulluar gjendja pa nevojë, por në fund iu falënderoj për mirëkuptim.

3.7 Propozim vendimi për lejimin e ndërtimit të Palestrës së Sporteve në Zhegër-Komuna e Gjilanit

Nevzad Rushiti- për këtë rast nga Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit është një kërkesë urgjente që KK i Gjilanit ta identifikojë dhe ndajë një hapësirë për një hallë sportive. Ne si komitet jemi takuar urgjentisht dhe e kemi dërguar rekomandimin për Kuvend. Këshilli i fshatit, ka marrë një qëndrim për parcelën se ku do të ndërtohet kjo hallë e sporteve, prandaj në rast se çdo gjë është e qartë, financimi i hallës së sporteve bëhet nga ministria, kurse parcela është ndarë nga këshilli i fshatit dhe kërkoj që të aprovohet ky propozim - vendim.

Jehonë Hyseni- ndërtimi i një halle sportive në fshatin Zhegër është një lajm i mirë për të gjithë banorët e Zhegrës dhe gjithë fshatrave tjera rreth këtij fshati. Me ndërtimin e kësaj halle sportive, të rinjve do t' i mundësohet që aktivitetet e tyre rekreative dhe sportive do t' i bëjnë aty dhe në këtë mënyrë do ta kenë mundësinë që t' i ikin dukurive negative. Unë në emër të Këshillit të fshatit iu ftoj që ta aprovoni këtë propozim –vendim, sepse është tejet i dobishëm për fshatin Zhegër dhe fshatrave të tjera.

Isa Agushi- në fshatin Zhegër 120 hektarë tokë që po thuhet, por ajo është tokë kodrinore dhe e dyta ky është projekti i dytë pas 15 viteve, sepse më parë është ndërtuar një shkollë. Është një fat i jonë, sepse po duhet t' i gëzohemi këtij investimi, sepse kur nuk ka gjëra më të mira edhe kjo është një lajm i mirë. Unë i thërras të gjitha partitë politike që ta aprovonjë këtë propozim-vendim edhe pse fillimisht nuk jam pajtuar me parcelën e cila është propozuar për ndërtim të kësaj halle sportive. Mirëpo duhet ta votojmë, sepse është investim i Qeverisë dhe nuk duhet të lejojmë që të na humbin mjetet.

Bajram Hasani- edhe unë e mbështesë këtë propozim për ndërtimin e palestrës sportive, sepse është në interes të fshatit Zhegër dhe në tërësi asaj treve.

Renan Imam – edhe unë e përgëzoj këtë propozim dhe në plotësi pajtohem që të bëhet një investim i tillë, sepse është në dobi të të gjithë banorëve të fshatit Zhegër me theks të veçantë të rinisë së këtij fshati.

Arben Maliqi- ky është një lajm i mirë, jo vetëm për Komunën e ardhshme të Zhegrës, por edhe për të gjithë qytetarët, sepse dihet se Zhegra ka shumë fshatra në afërsi dhe ka sportistë të dalluar. Në Zhegër është Klubi i Hendbollit i cili është një klub mjaft i mirë. Mirëpo është mirë që të kemi kujdes dhe ta dimë se si po ndërtohet kjo palestër? Po ndërtohet me standarde apo sikur në të kaluarën ku nuk është menduar mirë se çka duhet të ndërtohet. Për këtë palestër duhet të jetë një Komision përkatës për t' i përcjell punët duke filluar nga lartësia, nxehja dhe standardet tjera. dhe jo vetëm të ndërtohet për të funksionuar vetëm verës.

Izmi Zeka- ne në emër të grupit të PDK-së e përkrahim këtë iniciativë, duke dëshiruar që kjo iniciativë të bëhet sa më parë realitet dhe të jetë e ndërtuar sipas standardeve bashkëkohore. Kjo është një iniciativë e dobishme për të rinjtë e këtij fshati, kurse ne pa rezervë e përkrahim.

Fehmi Sylejmani- edhe si grup i LVV e përkrahim këtë iniciativë, por me sa e kuptova unë kryetarin e komiteti e tha se pika e rendit të punës ka ardhur aty për aty. Nëse është ashtu ne po i hyjmë kësaj pune në mënyrë të paligjshme, sepse me sa po shihet se po i duket cinike kjo, por duhet ta dimë se shumë ka shkelje në këtë Kuvend. I bëjmë nganjëherë disa shkelje, kur nuk ka nevojë për nxitim. Unë plotësisht e përkrahi këtë iniciativë dhe i tha shumë gjëra Arben Maliqi, por nuk e tha se Zhegra garon në super ligë dhe Zhegra e përfaqëson Komunën tonë në super ligë. Për këtë arsyeje gjithçka që bëhet për sport dhe të rinjtë ne do ta përkrahim.

Selami Xhemajli- ne e kemi përkrah këtë projekt edhe në KPF me gjithë vërejtjet që i kemi pasur. Mirëpo u përmend urgjenca e shqyrtimit të kësaj pike me të drejtë, por kjo nuk është hera e parë, sepse edhe herën e

parë kur është debatuar për Memorialin në fshatin Zhegër ky rekomandim na ka ardhur me urgjencë. Edhe kësaj radhe në Kuvend e kuptuam se nuk është zhvilluar debat në fshatin Zhegër se ku do të ndërtohet palestra sportive.

Mirëpo për hir të asaj që mos të na ik ky projekt në komuna tjera ne e mbështesim këtë propozim, por herëve të tjera le ta dinë Këshilli i fshatit se nuk janë kategori ligjore, prandaj për çdo iniciativë duhet të zhvillohet debat. Me këto vërejtje ne si AAK e përkrahim këtë propozim dhe i urojmë banorët e Zhegrës për këtë projekt, me dëshirë që të realizohet sa më shpejtë.

Nevzad Rushiti- unë do të jap disa sqarime dhe po theksoj se këtë shpejtësi e ka bërë dhuruesi i Zhegrës. Plotë 8 muaj ditë ky propozim ka qëndruar nëpër zyra të Komunës së Gjilanit.

Mirëpo duhet ta dimë se urgjenca është e ministrit, sepse në shkresat e tyre kërkojnë që për 15 ditë duhet të epet përgjigja. Unë si kryesuesi i komitetit më është dashtë ta thërras komitetin, ta propozojmë dhe ta rekomandojmë në mënyrë që mos të humb ky projekt.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 3.7 e rendit të punës?

Aprovohet pika 3.7 e rendit të punës: Propozim vendimi për lejimin e ndërtimit të Palestrës së Sporteve në Zhegër-Komuna e Gjilanit, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm së sallë (32).

3.8 Propozim vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për ndërrimin e destinimit të hapësirës së një pjese të PDU :Dardania-I (te ish lokacioni i tregut)

Valon Shefkui- drejtori i DUMM, z. Shefkui para anëtarëve të Kuvendit e elaboroi këtë projekt me anë të kino- projektorit në mënyrë detale, duke dhënë sqarime se cilat objekte do të ndërtohen, sa do të ketë hapësirë të gjelbëruar dhe staza për kalimtarë.

Ismet Hajdini – unë jetoj në atë lokalitet dhe jam i lumtur që pas një periudhe mbi 30 vjeçare, më në fund po bëhet një projekt me interes jo vetëm për banorët e asaj lagjeje, por është në interes të të gjithë qytetarëve të Gjilanit. Sipas projektit po shihet se aty janë paraparë edhe dy fusha të tenisist të cilat Gjilani nuk i ka pasur asnjëherë. Gjatë kësaj periudhe janë bërë shumë plane dhe projekte, por gjatë pushteti të mëparshëm të viteve të nëntëdhjeta ka qenë një përpjekje për përfitime personale, por qytetarët e saj lagjeje e patën stopuar shitjen. Në këtë sipërfaqe prej 2 hektarëve, janë paraparë 4 fusha sportive dhe është me rëndësi se 50% e sipërfaqes është hapësirë e gjelbër dhe është e planifikuar një çerdhe. Për këtë projekt është paraparë një donacion prej 200 mijë euro, kurse Komuna do të participojë me 60 mijë euro. Unë apeloj te të gjithë anëtarët e Kuvendit që ta aprovojmë këtë projekt dhe të fillojnë punët sa më parë.

Arben Maliqi- ky është një projekt që qysh herët ka qenë deshtë të realizohet, mirëpo dëshirojmë që këtë vit do të zbatohet. Duhet theksuar se është një meritë e qytetarëve, sepse me fanatizëm e kanë ruajtur këtë vend edhe para dhe pas luftës, sepse është vend i shenjtë në lagjen “Dardania” e famshme. Dua ta përmendi se ky projekt ka qenë i hartuar më herë dhe nëse nuk gaboj kanë qenë përfaqësuesit e Holandës dhe është bërë një projekt mjaft i mirë. Aty ka qenë e paraparë të mbyllet rruga dhe për t’u harmonizuar mjaft mirë, mirëpo në ndërkohë është prishur ai projekt, sepse ka pasur interesa personale për të ndërtuar vetëshërbime dhe lokale afariste të tjera, mirëpo qytetarët e asaj lagjeje nuk kanë pranuar dhe për këtë arsyeje është bërë edhe prolongimi. Mirëpo këtë vit është një kënaqësi e madhe që në këtë projekt njeriu i cili i takon asaj lagjeje, drejtori Valon Shefkui. Ky projekt shumë bukur po duket në kino-projektor, por dëshirojmë që ky projekt të duket bukur edhe kur të realizohet dhe të jetë ashtu siç i ka hije. Unë e di që 240 mijë euro janë të pamjaftueshme për t’i bërë ky projekt ashtu siç është paraparë, prandaj duhet edhe drejtori së bashku me neve të kenë kujdes dhe fushat e sportit të ndërtohen sipas standardeve. Fushat e sportit mos të ndërtohen me asfalt dhe beton! Mos të jetë tribuna vetëm formalitet, sepse aty vijnë njerëz të moshuar për t’i shikuar fëmijët dhe nipat e tyre, prandaj duhet të ndërtohet siç duhet dhe i ka hije. Unë jam pesimist se me 240 mijë euro do t’ia

dalim për ta realizuar atë projekt, prandaj duhet të kërkohet edhe një donacion shtesë dhe ky projekt të jetë ashtu siç po shihet në kino-projektor.

Arben Mehmeti- ne kemi përvojë mjaft të hidhur përkitazi me këto projekte. Unë e di që për projektin e Tregut të Kafshëve ka qenë kërkesë e banorëve që të ketë sa më shumë gjelbërim, kurse tash e kemi një projekt të dështuar! Për këtë arsyeje është kërkesë e imja që sa më shumë të ketë gjelbërim, sepse është kërkesë e qytetarëve. Është mirë të hiqen tribunat dhe fushat nëse ka mundësi të jenë më të vogla, në mënyrë që gjelbërimi t' i shërbejë qytetarëve, sepse është më i nevojshëm në zemër të qytetit. Kjo është një kërkesë e imja, por edhe rrugët mund të jenë më të ngushta për të pasur sa më shumë gjelbërim.

Bajram Hasani- unë jam anëtar i Komiteti për Planifikim dhe plotësisht e përkrahi këtë projekt dhe pajtohem edhe me Arben Maliqin që kostoja për këtë projekt është e ulët, prandaj duhet kërkuar donacione edhe më tepër, por edhe gjelbërim mund të ketë më tepër.

Riad Rashiti- edhe ne si grup i anëtarëve të PDK-së e përkrahim çdo projekt i cili realizohet në Komunë të Gjilanit edhe atë për secilën lagjeje dhe vendbanim. Mirëpo sa i përket këtij projekti ne sa i përket këtij projekti kemi vërejtje, sepse në përshkrim financiar nuk janë paraqitur emërtimet se çka duhet të investohet dhe mungon për secilën pikë sa është vlere e investimeve dhe si projekt në total. Edhe ne mendojmë se një projekt i tillë nuk mund të realizohet me 240 mijë euro. Ne në qeverisjen e kaluar nuk kemi filluar projekt që ka dështuar, por ka qenë një projekt shumë i mirë i cili ka kaluar nëpër procedura dhe është miratuar në KK. Këtë projekt e ka përkrahur edhe ish koalicioni Arben Maliqi i cili sot po e kundërshton dhe po e akuzon se ka pasur interesa personale të dikujt. Ky projekt i cili është aprovuar në atë kohë ka pasur vetëm një interes. Interesi ka qenë që ajo lagje të ketë fusha sportive dhe me nevoja tjera që i duhen asaj lagjeje. Ne dimë që ka pasur disa kundërshtime për atë projekt, por e di që ai projekt ka qenë e planifikuar të financohet me një vlerë prej 1 milion euro. Mirëpo ju e dini që Komuna nuk ka mjete, por si ide ka qenë që ai projekt të realizohet përmes PPP-së e cila ide është kundërshtuar. Ne mendojmë se edhe ky projekt është mjaft i mirë, por çmimi ka zbrit jashtëzakonisht shumë dhe mendojmë se me këto mjete nuk do të finalizohet ky projekt. Ne mendojmë se ky projekt do të fillojë dhe nuk do të realizohet, prandaj nuk jemi për t' i përkrah projektet të cilat i dimë në start se do të fillojnë, por nuk do të përfundojnë!

Fehmi Sylejmani- në këtë rast po flas nga pozita e në qytetari që i takoj kësaj lagjeje dhe pajtohem me shumicën e parafolësve. Mirëpo po iu them edhe një të dhënë të cilën e kam marrë nga drejtori i Financave se taksapaguesit më të rregullt në Komunë janë qytetarët e Dardanisë dhe janë shumë të ndërgjegjshëm. Këta qytetarë nuk e meritojnë vetëm këtë projekt, por meritojnë shumë më shumë se ky projekt. Unë po pajtohem me disa parafolës e sidomos me Arben Maliqin i cili e tha që fushat e sportit mos të bëhen me beton dhe asfalt, sepse janë të dëmshme për fëmijët. Uroj që ky projekt të fillojë mbarë, të vazhdojë dhe përfundojë ashtu siç duhet., sepse këtë e meritojnë qytetarët e Dardanisë.

Në fund e kam një pyetje për drejtorit e DUMM: “ Kush e ka bërë hartimin e këtij projekti “?

Arben Maliqi-ndoshta i kujtohet Riadit kur kanë ardhur holandezet, kurse projektin e ka prezantuar Qefsere Sadriu dhe ka qenë një projekt jashtëzakonisht i mirë. Mirëpo në ndërkohë është bërë një shkelje ligjore, sepse iu ka ndërruar destinimi. Më parë ka qenë projekti shumë i mirë i paraparë me drunj të lartë, fusha amfiteatër dhe në këtë mënyrë projekti ka qenë i përkryer. Mirëpo në ndërkohë e kemi marrë një vendim këtu e ka prezantuar Arbenita ku ka qenë paraparë të hapet rruga dhe të ketë vetëshërbim, do të thotë të ketë edhe lokale afariste dhe për këtë arsyeje ne kemi qenë krejtësisht kundër. Kjo ka qenë kështu, kush dëshiron që ta dijë!

Ismet Hajdini- edhe mua po më duket se mjetet janë të pamjaftueshme për këtë projekt, sepse me sa e kuptova unë 250-60 mijë euro duhen mjete vetëm për gjelbërim të fushave, kurse çerdhja është plus e cila kushton 3-400 mijë euro. Nuk duhet kuptuar se i tërë projekti është 260 mijë euro dhe këto mjete janë pak.

Isa Agushi- unë para pak dite kam qenë Zvicër dhe ky projekt po më duket sikur të jetë në Zvicër dhe dëshiroj të bëhet siç po shihet në kino-projektor, por unë nuk besoj që do të jetë kështu me këto mjete të cilat i keni paraparë. Nëse dyfishohen mjetet, besoj se do të jetë një projekt shumë i qëlluar ashtu si e meriton ajo pjesë e qytetit.

Valon Shefkriu- përsëri z. Shefkriu dha sqarime për këtë projekt me anë të kino-projektorit duke e bërë krahasimin e këtij projekti me atë të qeverisjes së kaluar dhe duke i sqaruar se çka është hequr në projektin e kaluar dhe si është plotësuar në këtë projekt të sotëm. Me 240 mijë euro është planifikuar vetëm ana e djathtë.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 3.8 e rendit të punës?

Aprovohet pika 3.8 e rendit të punës: Propozim vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për ndërrimin e destinimit të hapësirës së një pjese të PDU :Dardania-I (te ish lokacioni i tregut), me 26 vota të anëtarëve të Kuvendit, 3 ishin kundër, kurse të tjerat abstenime.

3.9 Rishqyrtimi i nenit 3 pika 1 të Rregullores për plotësim dhe ndryshim të Rregullores për taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale (sipas rekomandimit të Komisionit të përbashkët të MF-MAPL)

Hevzi Matoshi- Komisioni i përbashkët ndërministror i Ministrisë së Financave (MF) dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me dt. 13.01.2015 ka pranuar dhe ka marrë në shqyrtim Rregulloren për plotësimet dhe ndryshimet e rregullores për taksa ngarkesa e gjoba 01. nr. 016-144322 të komunës së Gjilanit të miratuar nga KK-ja me dt. 30.12.2014 dhe lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë ka kërkuar të harmonizohet neni 3 pika 1 e rregullores në fjalë sepse është në kundërshtim me nenin 10 pika 3 të Ligjit për financa të pushtetit lokal nr. 03/L-049.

Po ashtu edhe pse në shkresë të komisionit nuk është cekur decidivisht, kërkohet që me rastin e caktimit të mundshëm të taksës komunale për veprimtari të ndryshme biznesore të mos merren parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 10 paragrafi 4 të ligjit për financat e pushtetit lokal duke përfshirë edhe m².

Formulimet ku përmendet m² duhet hiqet nga neni 3 pika 1 i rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba të miratuar me 30 dhjetor 2014 duke harmonizuar tarifat nr. 12,13,14,15,16,20, 21, 22 dhe 23.

Harmonizimi ka të bëjë lidhur me emërtimet e përmendura në tekstin e tarifave për biznese ku është kërkuar që të hiqen emërtimet aktuale për disa biznese dhe emërtimi të jetë në pajtim me terminologjinë që përdoret në Ligjin për ndërmjet publike dhe nenin 10 paragrafin 3 të ligjit për financat e pushtetit lokal nr. 03/L- 049.

Në vijim të fjalës së tij z. Matoshi i paraqiti edhe tarifat e miratuara më 30.12.2014, në formë tabelave.

Tarifat e miratuara më 30.12.2014

Duke pasur parasysh arsyetimin që u paraqit lidhur me harmonizimin e rregullores në fjalë po paraqesim edhe riformulimin e ri i cili do të ketë këtë përmbajtje si në vijim:

Te neni 3 paragrafi 1 i rregullores mbi plotësimin dhe ndryshimin e rregullores fjala “Kompani” zëvendësohet me fjalën “ndërmarrje” dhe të gjitha emërtimet e përdorura në tekstin e taksave fshihen.

- Tarifa nr. 12 fshihet
- Tarifa 13 fshihet fjala “prej 200-300m²”

- Tarifa nr. 14 fshihet
- Tarifa nr. 15 vlera e tarifës “500” zëvendësohet me “400”
- Tarifa nr. 16 fjala “mbi 500m²” fshihet dhe vlera e tarifës “1000” zëvendësohet me “800”
- Tarifa nr. 20 fjala 200-300m² fshihet dhe vlera e tarifës “300” zëvendësohet me “200”
- Tarifa nr. 21 fshihet.
- Tarifa nr. 22, vlera e tarifës “500” zëvendësohet me “400”
- Tarifa nr. 23, vlera e tarifës “400” zëvendësohet me “300”.

Tarifat pas harmonizimit:

2. Tarifat dhe ngarkesat prej 1-32 sipas nenit 4 paragrafi 1 të kësaj rregulloreje, mund të paguhen në 2 këste (kësti i parë deri më 30 qershor, kurse kësti i dytë deri më 31 dhjetor të vitit përkatës).
3. Subjektet afariste që operojnë brenda territorit të komunës në ma shumë lokacione paguajnë 40% të bazës së tarifës.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 3.9 e rendit të punës?

Aprovohet pika 3.9 e rendit të punës: Rishqyrtimi i nenit 3 pika 1 të Rregullores për plotësim dhe ndryshim të Rregullores për taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale (sipas rekomandimit të Komisionit të përbashkët të MF-MAPL, me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

3.10 Rishqyrtimi i vendimit 01.Nr.016-9262 për dhënien në shfrytëzim të ngastrës kadastrale P-70403013-00162-8 (sipas rekomandimit të MAPL)

Sadudin Berisha- KK në përbërjen e kaluar të saj ka nxjerr një vendim për ndarjen e një parcele në sipërfaqe prej 15 ari e cila sipërfaqe është dedikuar për raste sociale, i cili vendim është aprovuar në KK. Dhënia në shfrytëzim të pronës komunale rregullohet me ligj të veçantë dhe janë procedurat e sakta për rregullim të kësaj çështje. Edhe pse është monitoruar puna e KK-së nga MPL-ja, atë vendim nuk e ka shpall si të paligjshëm, por e ka heshtur. Mirëpo KK ka filluar zbatimin e këtij vendimi përmes Drejtorisë për Shëndetësi dhe Komisionit për ndarjen e trojeve dhe është për shtatë troje që janë dhënë 6, janë realizuar, kurse ka mbetur vetëm trolli i shtatë i fundit i përealizuar. Mirëpo MPL e monitoruar nga LDK këtë vendim e ka shpallur të paligjshëm. Ne të vetëdijsëm si opozitë e kemi ditur se ka qenë vendim i paligjshëm, pavarësisht nevojave sociale të cilat janë të shumta për ndarje të trojeve, por janë proceduar dhe përcaktuar edhe mënyra se si ndahen hapësirat për ndërtim kolektiv për raste sociale, ajo nuk ka ndodhur. Tetë ari janë dedikuar nga 2 ari sipërfaqe dhe 7 ari kanë mbetur për ndërtim social. Mirëpo me vendim të veçantë të KK-së në përbërjen e kaluar ai 7 ari që është planifikuar për ndërtim social kolektiv është shndërruar në tri troje, dy prej të cilave veç janë ndërtuar, kurse një ka mbetur ende i pandarë personit të caktuar.

Drejtori për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë me kërkesën e organeve përgjegjëse ka proceduar realizimin e pjesës së fundit të asaj, duke ia ndarë Fatmir Isufit parcela për ndërtim të shtëpisë sociale në tokën e Komunës. Dhuruesi është gjetur dhe është betuar se do t’ia ndërtojë shtëpinë.

Ky vendim i pjesshëm është shpallur nul nga Ministria e Administratës së Pushteti Lokal, por jo edhe pjesa tjetër e cila praktikisht është ekzekutuar. Këtë po e them, sepse te ne politika po zbatohet për së mbrapshti, jo në zbatim të ligjit, por po ndodh varësisht se cila parti ku është vendosur. Nëse është partia e “ime e dashur” i heshti reagimet e mia të detyrueshme ligjore për të thënë se ky vendim nuk është në rregull, por kur është një parti e cila nuk është “e zemrës sime” ky është vendim i paligjshëm. Në këtë situatë ne jemi të detyruar për ta zbatuar rekomandimin e MPL-së, por jemi të pafuqishëm për ta rikthyer gjendjen e vendimit të vitit 2009.

Mua më ven keq për rastin që ka ndodhur, por më vjen mirë që ministria reagon për raste të tilla!

Mirëpo jo të reagojë pse është LDK-ja, por është dashtë të reagojë edhe kur ka qenë PDK, por mund të vijë edhe ndonjë subjekt politik për vendime të paligjshme. Gjendja është kjo dhe vendimi duhet zbatohet e ne jemi të detyruar për t' i zbatuar vendimet e pushtetit qendror që janë në harmoni me ligjin, do të jemi në situata jashtëzakonisht të vështira lidhur me atë se çka do të ndodh me parcelat e tjera të ndara brenda asaj sipërfaqe prej 15 mijë e 500 metrave? Në fund se si do t' ia bëjmë, do t' ia bëjmë si duhet, por vërtetë është e padrejtë tash ta përjashtojmë këtë rast, sepse rastet tjera janë zgjidhur në këtë parcelë.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 3.10 e rendit të punës?

Aprovohet pika 3.10 e rendit të punës: Rishqyrtimi i vendimit 01.Nr.016-9262 për dhënien në shfrytëzim të ngastrës kadastrale P-70403013-00162-8 (sipas rekomandimit të MAPL), me 27 vota të anëtarëve të kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

Të ndryshme

Arben Maliqi- unë nën të ndryshme po e ngris Stadiumin e qytetit të Gjilanit, i cili stadium është shumë i mirë dhe të cilit Stadium ia kanë lakmi të gjitha qytetet tjera në Republikë të Kosovës në të cilin stadium janë të angazhuar tre punëtorë të cilët e mirëmbajnë këtë stadium. Punë e këtyre punëtorëve është e mrekullueshme, por problemi qëndron që çështja e tyre nuk është zgjidhur me kohë. Mirëpo për këtë është një marrëveshje, por ajo nuk zbatohet dhe ata punëtorë edhe pse kanë kaluar 7-8 muaj nuk kanë marrë paga. Kërkoj që Memorandumi i cili është bërë në mes këtyre punëtorëve dhe DKRS-së të zbatohet dhe ata punëtorë t' i marrin pagat, sepse janë në gjendje të rëndë, kurse njëri prej tyre është edhe në gjendje jo të mirë shëndetësore. Ju lus që këtë çështje ta shqyrtoni seriozisht !

Leonore Bunjaku – unë fillimisht deshta ta bëj një pyetje për drejtorin e arsimit i cili fillimisht nuk ishte në seancë, tentova më vonë, por iku kryetari, kurse tash në fund nuk është prezent as kryetari as drejtori. Kujt unë tash t' i drejtohem? Së pari është bërë largimi i disa drejtorëve dhe zv/drejtorëve, mandej pranimi i disa punëtorëve pa konkurs, por ka raste edhe kur është bërë edhe pranimi i punëtorëve pa kriteret ! Shtrohet pyetja se çfarë plane keni me ata punëtorë që i keni larguar lidhur me atë se diplomat nuk janë valide, kurse të tjerët janë duke punuar? Nuk e di sa jeni ju të njoftuar, por unë jam e obliguar për ta përcjell shqetësimin e 120 studentëve të cilëve nuk iu njihet diploma e Kolegjit “Gjilani” edhe pse ato diploma janë protokolluar në Ministrinë e Arsimit. Të tjerëve iu lejohet të punojnë, kurse të diplomuarve në këtë kolegji nuk iu lejohet! Ku është dallimi pse nuk iu lejohet të punojnë këta të diplomuar në këtë Kolegj të punojnë në arsim?

Mandej edhe një çështje tjetër e cila është shumë e vonuar e ajo është çështja e emërimit të shkollave e cila çështje është shqyrtuar në Komitetin e Arsimit, por nuk është proceduar më tutje. Ju lus që ta shqyrtoni këtë çështje dhe të hyjë në rend të punës në seancë të Kuvendit.

Problematikë tjetër në kompleksin e shkollave të mesme është se objekti i Ekonomisë së Pyjeve i cili ende qëndron aty dhe nuk është ndërmarrë asgjë, prandaj ju lus që të ndërmerret diçka në këtë drejtim?

Si çështje tjetër e cila po më bën përshtypje në këtë pushtet është ajo e barazisë gjinore, sepse ka dallime të mëdha, sepse nuk e kemi asnjë drejtoreshë në këtë qeverisje!

Valentinë Bunjaku-Rexhepi – në fillim të seancës ishte debati rreth pikave të cilat dëshironi për t' i debatuar, kurse në vazhdimësi ishte edhe raporti i kryetarit të Komunës, por ishte edhe drejtori i arsimit prezent dhe këtë që po e thoni tash është e pakuptimtë! Sa i përket 120 diplomave nuk është përgjegjësi e Komunës, por është e Ministrisë së Arsimit. Gjithashtu edhe emërtimi i shkollave nuk është në kompetencë të KK-së.

Ismail Jonuzi- objekti i Ekonomisë së Pyjeve është një problem i trashëguar dhe këta punëtorë janë në një objekt me Inkubatorin e Biznesit. Nuk qëndron fakti që e tha zonja Bunjaku se AKP nuk është informuar, sepse ne i kemi bërë dy shkresa. Mirëpo edhe i kam pasur edhe dy takime me përfaqësuesit e AKP-së. Mirëpo për shkak të mungesës së Këshillit të AKP-së, nuk është marrë asnjë vendim në një periudhë prej një viti e më tepër.

Nevzad Rushiti- unë e kam një shqetësim të një grupi i qytetarëve afër 500 të Komunës së Gjilanit me rrethinë e të cilët qytetarë kanë pasur intervenime të ndryshme kirurgjike, duke filluar nga valvula e zemrës dhe operacione të tjera. Këta njerëz i bëjnë disa analiza të kuagolimit të gjakut e të cilët janë të obliguar që këto analiza t' i bëjnë në Prishtinë. Këta njerëz për këto analiza edhe pse në gjendje të rëndë maltreohen shumë, prandaj komiteti duhet të merret me këtë çështje, sepse dhuruesit e kanë sjell një aparat për këtë analizë, por nuk ka mjek specialist për këtë analizë. Duhet që sa më urgjent që të bëhet zgjidhja e këtij problemi, sepse pacientët vuajnë mjaft gjatë rrugës Prishtinë- Gjilan dhe anasjelltas.

Jashar Jashari- është e vërtetë se këto analiza bëhen në Prishtinë, sepse në Gjilan ka mundësi të bëhen, por ka mundësi të shkojë në trajnim nga reparti i Transfuzionit të Gjakut dhe pas këtij trajnimi ka mundësi të zgjidhet ky problem. Kjo problematikë duhet të trajtohet në komitet, pastaj do të shikohet mundësia e zgjidhjes së këtij problemi.

Leonorë Bunjaku- unë nuk e di sa isha e qartë, por unë e sqarova pse nuk e mora fjalën në fillim të seancës e arsyeja ishte, sepse nuk ishte prezent drejtori. Zonja kryesuese e tha se fajtor është Ministria, por në Ministri këto diploma janë të protokolluara. Mirëpo si është e mundur që nga drejtoria një person është i diplomuar me të njëjtën diplomë nga ai Kolegj në Kishna Pole (Mirsade Ismajli), kurse zv/drejtores në “Abaz Ajeti” iu ka mohuar edhe intervista. Pse është ky dallim, dikujt i mundësohet, dikujt i mohohet!?

Sa i përket objektit të Ekonomisë së Pyjeve, këtë çështje e ka neglizhuar kryetari i Komunës dhe asnjë hap nuk është bërë për ta zgjidhur këtë problem.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- në Kishna Pole nuk ka pasur kuadër tjetër, prandaj është pranuar Mirsade Ismajli, kurse në “Abaz Ajeti” është respektuar ligji dhe nuk ka pasur mundësi intervistimi për zv/drejtoreshen.

Arben Maliqi- është vërtetë çështja e të diplomuarve në kolegje, sepse disa komuna i lejojnë që këta të diplomuar të punojnë, por në disa komuna nuk i lejojnë? Mirëpo sipas ligjit ata që diplomojnë në kolegje nuk kanë të drejtë të punojnë në arsim!? Me sa e di unë kjo është e drejtë e kryetarëve të Komunës të cilët vendosin se a mund të punojnë këta të diplomuar në arsim apo jo?

Selvete Shurdhani- përkitazi me trombo testin ose faktorët e kuagolimit, janë analiza që kryhen në Transfuzion të Gjakut. Mirëpo Transfuzioni i Gjakut është i ndarë, aparati ekziston, doktoresha specialiste është, por edhe ka qenë vullnet i Spitalit të Gjilanit për t' u kryer këto procedura, reagesat ekzistojnë, por transfuzioni i Gjakut është njësi e veçantë dhe ata janë njësi e Transfuzionit të Gjakut në Prishtinë. Çdo gjë duhet të zbatohet përmes Transfuzionit të Gjakut në Prishtinë.

Nevzad Isufi- unë e kam një vërejtje zonja kryesuese, sepse ju e keni thënë se drejtorët duhet të qëndrojnë në seancë gjatë tërë kohës, por tash në përfundim të seancës më tepër se gjysma e drejtorëve nuk janë të pranishëm. Sot drejtori i Arsimit erdhi i fundit dhe shkoi ndër të parët, prandaj çështjet që kanë të bëjnë me arsimin ne nuk mund t' i shtyjmë, sepse janë të tilla që nuk mund të shtyhen. Fjala është për pensionistët në arsim të cilët nuk po i marrin tri rrogat e të cilat janë të

përcaktuara sipas ligjit. Disa i kanë marrë këto pensione përcjellëse disa jo, prandaj pse duhet ndjekur rrugën përmes gjykatës për ta realizuar këtë të drejtë?

Mandej në drejtori të Arsimit po bëhen disa shkelje; si punësimi pa konkurs, disa emërimet e reja të drejtorëve pa sqarime, por është edhe një ankesë e profesorit të historisë (Ilir Hasani), sepse me rastin e pensionimit të një punëtoreje, nuk është shpallur konkurs, por është bërë zëvendësimi dhe është mohuar e drejta e konkursit. Mirëpo kur ai person ka konkurruar në shkollën fillore, iu është thënë se keni shkollim mbi kualifikimin fillor. Sipas kësaj qenka problem edhe mbi kualifikimi nëse konkurron në një vend pune. Të na epet sqarime pse po ndodhin punësime pa konkurs, pse kemi transefere të drejtorëve dhe emërimet e paligjshme?

Fehmi Sylejmani- u tha nga kolegu i im se shumica e drejtorëve në fund të seancës nuk janë të pranishëm, por unë disa çështje do t' i ngris dhe e para është:

Çka po ndodh me zhvendosjen e sektorëve të ndryshëm në komunë, derisa qytetarët sorollaten poshtë e lart. Si është e mundur të bartet sektori për tatim në pronë në këtë objekt, poshtë nesh, kati i dyti, kur dihet se në mesin e qytetarëve ka edhe të hendikepuar që nuk mund të ngjiten në shkallë, kjo është në kundërshtim me ligjin për personat me aftësi të kufizuara. Pse po bëni punë të panevojshëm dhe të kushtueshme, vetëm për të arsyetuar diçka kinse po punojmë ?

1. Pse delegacioni në përbërje nga disa anëtarë të kuvendit dhe kryesueses, që ishin kohë më parë në Turqi nuk kanë dhënë asnjë informatë apo raport për këtë udhëtim. Çfarë qëllimi ka pas kjo vizite dhe kush ka qenë në këtë ekspeditë, përveç anëtarëve të Kuvendit ?
2. Pse nuk është futur në rendin e ditës në këtë seancë një pikë për “Flakën e Janarit, e cila tashmë ka hy në muajin e dytë që ka përfunduar ?
3. Sa persona janë të punësuar pa kontrata dhe sa të pakualifikuara ?
4. Pse po angazhoni praktikantë në njësinë e inspeksionit, kur ata shumë lehtë mund të keqpërdorin detyrën, madje edhe pa dashje ?
5. A ka inspektor sanitar dhe të ndërtimit në komunë dhe cilët janë ata, nëse mund të na thoni me emër dhe mbiemër ?
6. Pse nuk po e rregulloni njëherë e përgjithmonë çështjen e tre punëtorëve teknik-ndihmës në stadiumin e qytetit, të cilët që nga muaji shtator i viti të kaluar janë pa asnjë pagë ?

Arijetë Rexhepi- çështjen të cilën do ta ngriti është pengesa për një jetë normale dhe të dinjitetshme në fshatin Kmetoc. Në këtë fshat banorët furnizohen me ujë nga puset, uji të cilëve nuk është i pijshëm edhe pse ky fshat e posedon rrjetin e ujësjellësit, por vetëm i mungojnë njehsorët për ta pasur ujin e pijshëm në shtëpitë e tyre. Kur do të zgjidhet problemi i njehsorëve të ujit në këtë fshat?

Në oborrin e shkollës së fshatit Kmetoc është rregulluar fusha e futbollit, por ende i mungon rrjeti anësor e cila është paraparë për t'u vendosur, prandaj kur do të përfundojë edhe kjo çështje?

Gjatë fushatës në këtë fshat është premtuar se do të shtrohet rruga me asfalt, por rrugët ende janë të paasfaltuara, por problem tjetër është edhe mungesa e një ambulance në këtë fshat, kurse pacientët për një inzheksion duhet të udhëtojnë në Gjilan.

Problem tjetër të cilin duhet theksuar është edhe barazia gjinore, sepse vetëm në Shkollën “Selami Hallaçi” si punëtorë të rinj janë pranuar drejtori, zv/drejtori sekretari, pedagogu për pa e përfillur barazinë gjinore, sepse nga ky kuadër nuk është asnjë femër. Në atë shkollë 80% e punëtorëve janë femra, duhet ta mendoni këtë çështje dhe mos të bëhen këso pabarazi!

Ismet Hajdini – unë mendoj se çdo anëtarë i Kuvendit, mund të bëjë pyetje me shkrim ose gojarisht në Kuvend dhe nuk është e domosdoshme menjëherë drejtori të jep përgjigje, sepse ndoshta nuk

është i përgatitur dhe nuk i posedon shënimet aty për aty. Drejtori mund të përgjigjet me shkrim ose në seancën e radhës, nuk është hendikep, pse mungon drejtori në seancë.

Bujar Nevzadi- unë i kam disa shqetësime për fshatin tim Përlepnice. Nën një është dëmtimi i pendës në fshatin Përlepnice e cila çështje është ngrit edhe në nivel të Kuvendit të Kosovës.

Shtëpia e Kulturës në Përlepnice ka filluar më herët dhe është ndërprerë, prandaj kërkoj që të vazhdohen punimet. Si çështje e tretë është se në këtë fshat më tepër se një muaj nuk vjen mjeku në vizitë në ambulancë të fshatit.

Zijadin Maliqi- nuk kam çështje për të shtruar, pro sa i përket punës së Kuvendit, ne fillimisht i kemi 30 minuta për këtë çështje, kurse në fund po na dalin edhe shumë minuta për këto çështje. Ato gjëra që shtrohen në rendin e punës, nën të ndryshme nuk duhet të përsëriten dhe të humbim shumë kohë. Drejtori i cili nuk ka ndonjë sqarim ose pyetje nuk është e nevojshme të qëndrojë në seancë.

Nevzad Isufi- fjala është për rastet e pensionimit dhe dihet qysh tash kush kur do të pensionohen mesimdhënësit, pse duhet të pritet ditën e fundit, të bëhet zëvendësimi, pastaj të hapet konkursi. Qysh tash dihet se kur kush mund të pensionohet?

Fehmi Sylejmani- unë shtrova pyetje shumë konkrete; çka është përfituar nga vizita e kryesueses me delegacion në Turqi? E dyta kush iu ka dhënë të drejtën kryesueses për ta marrë asistenten në këtë vizitë me paratë e taksapaguesve të qytetarëve të Gjilanit? Kjo është e padrejtë dhe është keqpërdorim nga ana e kryesueses!?

Valentina Bunjaku- Rexhepi- nga kjo vizitë e kemi sjell një fushë ndihmës për të cilën është nënshkruar një marrëveshje. E dyta asistentja ime nuk merr mëditje sikur ne anëtarët Kuvendit dhe kjo mund të verifikohet në shpenzime të buxhetit. Unë asnjëherë nuk shkojë në vizitë pa asistente pa marrë parasysh a i pëlqen dikujt apo jo?

Me këto debate dhe vendime në ora 18.20 minuta, seanca i përfundoi punimet

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjaku –Rexhepi